



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# PËRSE E PRANUAM FENË ISLAME RRËFIME TË VËRTETA

Mexhid Yveysi

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

FJALA E PËRKTHYESIT .....	5
UMAR MITA, EKONOMIST (JAPONI) .....	10
MUHAMMED A. HOBOHM, DIPLOMAT (GJERMANI).....	11
JOSEPH AMADO, PRIFT KATOLIK (SIERRA-LEONE) .....	13
ALI SELMAN BENOIST, DOKTOR I MJEKËSISË (FRANCË).....	14
MIJËRA FRANCEZË E PRANUAN ISLAMIN .....	16
HATEM HOURI, GAZETAR (BEJRUT, LIBAN).....	17
DONALD S. ROCKWEL, POET, KRITIK LETRAR (SHBA) .....	19
FADLULLAH WILMONT, HISTORIAN (AUSTRALI).....	21
ANTONIO CARIOVATO, FILOZOF (ITALI).....	26
JOHN WEBSTER, FILOZOF (ANGLI).....	28
FATIME KAZUEI (TOKIO, JAPONI) .....	30
MARGARET MARCUS, SHKRIMTARE (NJU-JORK, SHBA) .....	33
SUZANNE HANEEF, GAZETARE (SHBA).....	37

PËRSE PRIFTI PROTESTANT, RABINI ÇIFUT DHE NJË GJYSHE GJERMANE E PRANUAN FENË ISLAME? .....	40
DR. ROLF BARON EHRENFELS, SHKENCËTAR, ANTROPOLOG (AUSTRI).....	43
MUHAMMED SULEJMAN TAKEUCHI, ETNOLOG (TOKIO, JAPONI).....	46
DR. R. L. MELLEME, ANTROPOLOG (HOLANDË) .....	49
MUHAMMED A. RUSSEL WEBB, DIPLOMAT (SHBA).....	52
TREGIMI I PRANIMIT TË ISLAMIT NGA NJË VAJZË ÇIFUTE .....	54
DY FJALË PËRMBYLLËSE .....	57

## FJALA E PËRKTHYESIT

Njerëzit, krijesat më të bukura të All-llahut të Madhërueshëm në sipërfaqen e tokës ku jetojnë, me të gjitha bekimet, janë shtuar aq shumë saqë numri i tyre llogaritet të jetë gjashtë miliardë! Me shtimin e njerëzve është shtuar edhe dituria e tyre, dituri e cila ka arritur në një shkallë tejet të lartë. Por, megjithëkëtë, ata jetojnë në mosdije të thellë...!

Intelekti njerëzor jo vetëm që nuk është i aftë të zbulojë misteret e mëdha, por ai s'është në gjendje t'i zgjidhë as problemet e vogla me të cilat ballafaqohet vazhdimisht! Përndryshe, janë të paktë ata që dinë pse jetojnë dhe për ç'arsye. Aq më të paktë janë ata që dinë për kuptimin e jetës, të vdekjes dhe të ringjalljes...!

Zhvillimi dhe përparimi i shkencës, teknologjisë dhe industrisë jo vetëm që nuk e zhdukën varfërinë e mjerimin për milio-na njerëz, jo vetëm që nuk i përmirësuan marrëdhëniet e pa-drejtësitë njerëzore, por fatkeqësisht, ato dita-ditës shtohen edhe më tepër...!

Megjithëkëtë, ky zhvillim dhe përparim, e sidomos i shkencave fizike, biologjike dhe astronomike, na bën të kuptojmë më mirë se ku gjendemi në Gjithësi. Shkencëtarët thonë: “E ndiej-më veten tepër të mëdhenj kur zbulojmë diçka, por kur shohim se sa të panjohura ka në atë zbulim, atëherë kuptojmë sa të vegjël, sa të padijshëm jemi...!”

Shkurt, kjo është gjendja e njerëzimit që udhëhiqet dhe drejtohet nga civilizimi perëndimor, i cili po përpiqet me të gjitha fuqitë të zgjerohet në mbarë botën, të zgjerohet herë me dhunë e herë me mashtrime... Civilizimi perëndimor, i cili është vazhdimësi e civilizimit greko-romak, që u ngrit mbi themelet e po këtij civilizimi, sot nuk e mohon Zotin kategorikisht, por nuk lejon as nuk pranon që njerëzimi të udhëhiqet me Ligjet e Tij. Zoti, krijuesi i të gjithëve, është i përjashtuar nga bartësit e fuqisë së sistemeve politike, ekonomike, edukative etj. Besimi fetar është i lejuar për masat, por ka kuptim formal, sikur që kishin zotrat në Romën e lashtë pagane, të cilët adhuroheshin lirisht, por nuk kishin ndikim në shoqëri e as që u lejohej diçka!

Civilizimi perëndimor është materialist, pa Zot. Njeriun e shkretë e ka shndërruar në konsumues, shoqërinë në shoqëri konsumuese: prodho, shpenzo - ata fito! Por jo vetëm kaq. Ai vazhdimisht e nxit në lakmi, në grykësi, në shfrenim e në mëka-te të pafundshme...! Civilizimi perëndimor është një helm vdek-jepurës për çdo popull, për çdo kulturë që bazohet në vlera të mirëfillta njerëzore, aq më tepër, në vlera hyjnore...

Ne, shqiptarët, që ndodhemi në udhëkryq, nga t'ia mbaj-më?

Disa thonë se shpëtimi ynë është nga Perëndimi. Dhe rruga për në Perëndim kalon nga Vatikani, thonë vazhdimisht disa nga liderët politikë shqiptarë!

Vatikani, ku ndodhet Selia e Shenjtë, e trajton civilizimin perëndimor si: “Derë për të hyrë në fundin e botës, ku do të zhdukemi të gjithë...” Kurse bariu i saj, Papa Gjon Pali i Dytë, që udhëheq Bashkësinë (Kishën) Katolike, në veprën e tij “Evangelium Vitae” (Ungjillizmi i Jetës) e quan shoqërinë perëndi-more: “Shoqëri materialiste, egoiste, shoqëri e pornografisë, e abortit, e krimit, mashtrimit...”

Në një artikull të “New York Times”, gazeta me tirazh më të lartë në hemisferën perëndimore, thuhet se 18 për qind e amerikanëve pranojnë se janë viktima të mashtrimit, të cilëve njerëzit e paskrupullt u kanë marrë me mijëra dollarë...! Ameri-ka ka rreth 300 milionë banorë dhe 18 për qind prej tyre janë mbi 50 milionë banorë të mashtruar! Kur amerikanët i mashtrojnë amerikanët, po të tjerëve çfarë u mbetet? Çka i gjen?

Kurrë në historinë mbi dymijëvjeçare shqiptarët nuk vuaj-tën, nuk u varfëruan, nuk u masakruan më tepër se gjatë sundi-mit monist, komunisto-ateist, nga vetë shqiptarët...!

Ndoshta askush asnjëherë në histori nuk u mashtrua ashtu siç u mashtruan shqiptarët në demokraci, nga vetë shqiptarët...!

Këto janë disa nga frytet e civilizimit perëndimor, pa Zot, që në fillim duken të hijshme sepse shkëlqejnë, por ai shkëlqim të verbon, të mashtron e më në fund të helmon...!

“E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e Diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se janë ujë, derisa t’u afrohet e nuk gjen asgjë...” (Kur’ani, 24:39)

Jetohet nga puna, munda, djersa e jo nga fajdeja ose kamata. Për kamatën, Zoti i Madhërueshëm urdhëron e thotë:

“Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe pos siç ngrihet i çmenduri nga të prekurit e djallit. Këtë, ngase ata thanë: “Edhe shitblerja nuk është tjetër, por njësoj sikurse edhe kamata! All-llahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën...” (Kur’ani, 2:275)

Sikur vetëm këtë këshillë të Zotit ta kishim pranuar ne shqiptarët e shkretë, ashtu si jemi sot gjithsesi nuk do të ishim...! Në mungesë të besimit, shqiptarët janë shumë të dësh-përuar...! Të dëshpëruar në udhëheqës, në qeveri e në Nënë Shqipëri...! All-llahu i Gjithëdijshëm thotë:

“Ne ta shpallëm Kur’anin, që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshpërim.” (Kur’ani, 17:82)

“Kush nuk beson, barrën e mosbesimit të vet e ka kundër vetes...” (Kur’ani, 30:44). Ia rrënuan kulmin e tash po ia rrënoj-në themelin Shqipërisë...!

Martin Haidergeri, ndoshta filozofi më i madh i këtij shekulli, në një intervistë dhënë revistës së njohur gjermane “Der Spiegel” (Pasqyra), ndër të tjera thotë: “Filozofia nuk do të mund të shkaktojë ndryshim të drejtpërdrejtë të gjendjes së sotme në botë. Ky konstatim nuk vlen vetëm për filozofinë, por edhe për synimet e mendimet e tjera njerëzore. Mund të na shpëtojë vetëm Zoti. Si e vetmja mundësi na mbetet që të përgatitemi për Zotin, sepse me çdo alternativë tjetër do të dështojmë.”

Cili popull ka dështuar më shumë se ne shqiptarët? Cili është ai shqiptar me mendje të shëndoshë që dëshiron të dësh-tojë? Pra, nuk na mbetet asgjë tjetër, pas katastrofës kombëta-re që na gjeti, përveçse të përgatitemi për Zotin...! Ai është e Vërteta!

“All-llahu është Mbikëqyrës i atyre që besojnë, i nxjerr ata prej errësire në dritë...” (Kur’ani, 2:257)

“Prej Errësirës në Dritë” është titulli i librit që kam nderin t’ua paraqes lexuesve shqiptarë. Në këtë libër modest janë përfshirë dëshmitë e njëzet personaliteteve të ndryshme nga të gjitha

kontinentet e planetit tonë! Ata me vite të tëra kishin endur nëpër errësirë dhe më në fund, me ndihmën e All-llahut (xh.sh.), dolën në dritë dhe shpëtuan...!

Këto dëshmi të jetës së këtyre njerëzve i kemi përkthyer nga gjuha angleze, të cilat i kemi huazuar nga revista të ndryshme të Perëndimit e të Lindjes dhe gjatë dhjetë vjetëve (1987 - 1997) kohë pas kohe, ato janë botuar në revistën “Dituria Isla-me” të Prishtinës dhe në revistën “Hëna e Re” e Shkupit...

“Po, njeriu është dëshmitar i vetvetes.” (Kur’ani 75:14)

“Ka shpëtuar ai që është pastruar.” (Kur’ani: 87:14)

Të gjithë këta, që ishin shkencëtarë, diplomatë, filozofë, priftërinj katolikë, protestantë, rabinë çifutë (hebrenj) etj., dëshmuuan secili për vete dhe shpëtuan pasi u pastruan, por në këtë libër të gjithë janë të bashkuar! Ata ishin njerëz të arsyeshëm, me mendje të shëndoshë dhe e kuptuan të Vërtetën. E Vërteta i pastroi, i nxori nga errësira në dritë dhe i shpëtoi!

Edhe për ne shqiptarët ka shpëtim, por nëse kthehemi jo nga Perëndimi, se do të dështojmë vazhdimisht, por të kthehemi nga e Vërteta, All-llahu i Gjithëdijshëm. Nëse pastrohemi nga iluzionet, egoizmi, mburravecësia, kryeneçësia, inati, urrej-tja e shumë vese të këqija dhe dëshmojmë se s’ka zot tjetër përveç All-llahut (xh.sh.) e se Muhammedi (a.s.) është i Dërguari i Tij, mëshirë e mbarë njerëzimit. Nëse veprojmë e jetojmë sipas Kur’anit, Shpalljes së Fundit të All-llahut, që është shërim për të gjithë...! Mos të lejojmë më kurrë të biem në duart e ndonjë kirurgu duke e ditur se të gjithë pacientët e mëparshëm të tij kanë vdekur ose kanë mbetur të gjymtuar!

Mexhid Yvejsi

## UMAR MITA, EKONOMIST (JAPONI)

Gjatë tre vjetëve të fundit, me Mëshirën e All-llahut, jam duke kaluar një jetë të lumtur muslimane. Rruga e drejtë e jetës, siç na mëson Feja Islame, më është treguar nga vëllezërit misionarë pakistanezë, të cilët e vizituan atdheun tim (Japoninë), e ndaj të cilëve jam shumë mirënjohës.

Shumica e popullit tonë janë budistë, por ata janë budistë vetëm me emër. Ata nuk e zbatojnë Budizmin e as që kanë njohuri fetare. Arsyeja kryesore për këtë gjendje apatike është fakti se Budizmi paraqet një filozofi të ndërlikuar dhe nuk ofron diçka praktike. Për njeriun e thjeshtë, i cili është i ngarkuar me problemet e jetës, është i paarritshëm, i pakuptueshëm dhe i pazbatueshëm. E kjo nuk ndodh me Fenë Islame.

Mësimet e Fesë Islame janë të thjeshta, përparimtare dhe shumë praktike. Ato na drejtojnë në të gjitha fushat e jetës, e formulojnë mendimin e njeriut dhe kur të menduarit është i kthjellët, veprimet e pastra ndiqen vetvetiu. Mësimet islame janë aq të thjeshta, të lehta dhe aq praktike, saqë çdo njeri mund t'i kuptojë e t'i zbatojë në jetë. Ato nuk janë monopol i priftërinjve, siç ndodh në religjionet e tjera. Feja Islame në Japoni ka një ardhmëri që premtton. Japonezët po bëhen përditë e më tepër materialistë dhe më të dëshpëruar. Atyre duhet t'u tregohet se paqja e vërtetë është në Fenë Islame, që është një kod i përsosur për jetë dhe udhërrëfyese e të gjitha fushave të jetës.

Nëse Islami do të ketë sukses në Japoni, për të cilin jam fare i sigurt se një ditë do të ketë, të gjithë ata që e duan Fenë Islame do të duhet të mendojnë për këtë çështje dhe të përpri-qen e të bashkëveprojnë për këtë qëllim.

Jeta praktike e muslimanëve të këtillë, që janë besimtarë të vërtetë, mund të jetë shembull për të tjerët. Ata duhet ta vizitojnë Japoninë dhe ta mësojnë e udhëzojnë popullin në Fenë Islame. Populli ynë është i etshëm për paqe, për të vërtetën, për sinqeritetin dhe për çdo të mirë në jetë, andaj unë kam besim e shpresë se Islami mund ta shuajë etjen e pjesëtarëve të tij.

Islam do të thotë Paqe dhe s'ka popull në botë që e dëshiron paqen më shumë se japonezët. Paqja e vërtetë mund të vendoset vetëm duke e pranuar Fenë e Paqes (Islamin). Paqe me vetveten, paqe me njerëzit dhe paqe me Zotin. Vëllazërimi në Fenë Islame është një parim i veçantë dhe në të qëndron shpëtimi i njerëzimit.

Me mëshirën e All-llahut, pastaj me ndihmën e vëllezërve misionarë pakistanezë, e pranova Fenë Islame dhe në këto tri vitet e fundit jam duke jetuar një jetë të lumtur muslimane.

## **MUHAMMED A. HOBOHM, DIPLOMAT (GJERMANI)**

Përse ne në Perëndim po e pranojmë Fenë Islame?

Arsyet janë të shumta. Arsyeja e parë është: e Vërteta gjithmonë ka fuqinë e saj. Parimet kryesore të Fesë Islame janë racionale, natyrore dhe aq tërheqëse, saqë për një hulumtues të ndershëm të së

vërtetës është e pamundshme të mos impresionohet prej tyre. Për shembull: Besimi në një Zot (Monoteizmi). Sa natyrshëm udhëheq Feja Islame në barazinë e njerëzimit, sepse të gjithë jemi krijuar nga i njëjti Krijues dhe të gjithë jemi shërbëtorë të të njëjtit Zot.

Për kombin gjerman, në veçanti, besimi në Zotin është burim i frymëzimit, burim i trimërisë dhe burim i sigurisë. Ideja e jetës pas vdekjes të transformon. Besimi në Ditën e Gjykimit automatikisht e ndalon njeriun nga veprat e këqija, e ndërkohë e nxit të bëjë vepra të mira të cilat ia sigurojnë shpëtimin e përhershëm. Besimi në atë se askush s'mund t'u ikë pasojave të gjykitimit nga ana e Zotit, e bën njeriun të mendojë mirë para se të bëjë ndonjë të keqe. Me siguri ky vetëkontroll është më efikas se policia më e aftë në botë. Arsyeja tjetër që e tërheq të huajin ta pranojë Fenë Islame është toleranca. Namazi i përditshëm e edukon njeriun me përpikëri, ndërsa agjërimi në muajin e Ramazanit e ushtron besimtarin në vetëkontroll. Pa dyshim, vetëkontrolli dhe disiplina janë virtyte nga më të rëndësi-shmet për një njeri të mirë, për një burrë të vërtetë.

Komunizmi kishte gjëra pozitive, tërheqëse, sikurse që kanë edhe demokracitë sekulariste, por asnjëra prej tyre nuk ka një kod të përsosur për një jetë të ndershme, bujare. Vetëm Feja Islame e përsosur për njerëzimin është dhe kjo është arsyeja që unë e pranova dhe që njerëzit e mirë e përqafojnë atë.

Feja Islame nuk është një fe teorike. Aq më tepër ajo është një fe praktike dhe kuptimi i saj është: Nënshtrim i plotë ndaj Vullnetit të Zotit.

## JOSEPH AMADO, PRIFT KATOLIK (SIERRA-LEONE)

Prifti katolik, Joseph Amado, i cili shërbente në kishën “The New Papal Church of Kenema” të Sierra-Leones, deklaroi se e pranoi Islamin së bashku me dymbëdhjetë anëtarët e familjes së tij. Menjëherë pas pranimit të Islamit, prifti Joseph Amado e ndërroi emrin dhe tani quhet Ahmed Jusuf. Gjithë dokumentacionin zyrtar dhe atë konfidencial ia dorëzoi kishës.

Para se të bëhej musliman, Ahmed Jusufi mori pjesë në një konferencë fetare për Misionarët e Kishës në Frankfurt të Gjermanisë. Në atë konferencë ai qe i ngarkuar me detyrën që të ndërtonte një kishë të re në Sierra-Leone. Por, dëshira dhe vullneti i All-llahut ishte që Ahmet Jusufi të kalonte në Fenë Islame!

Lajmet për kalimin e priftit në Fenë Islame shkaktuan tronditje e befasi në qarqet klerikale, veçanërisht në Sierra-Leone. Aty kisha shfaqti frikë e brengosje, ngase ish-prifti ishte një predikues i njohur. Ahmed Jusufi deklaroi se edhe familja e tij dymbëdhjetanëtarëshe do të angazhohet në përhapjen e Mesazhit Islam. Ata do të apelojnë edhe te të tjerët që të kalojnë në Fenë Islame, në këtë fe me mësim e porosi të çmueshme.

Nga ana tjetër, rrethet islame e pranuan me shumë ngrohtësi përqaftimin e Fesë Islame nga Ahmed Jusufi, i cili thotë: “E gjeta rrugën për në Fenë Islame pas njëzet vjet studimi në literaturën islame, shkencat islame dhe bazat e saj.”

Revista e përjavshme amerikane “Newsweek” shkruan: “Krishterimi në Afrikë është një forcë në rënie, kurse Islami është një forcë në rritje, me dhjetë milionë muslimanë më shumë çdo vit!”

Në fund, Ahmed Jusufi thotë: “Do të përpiqem që edhe të tjerët ta përqafojnë Fenë Islame në Afrikë”, dhe lutet e uron: “Zoti do t’i udhëzojë edhe të tjerët nga errësira e idhujtarisë në Dritën Islame.”

## **ALI SELMAN BENOIST, DOKTOR I MJEKËSISË (FRANCË)**

As profesioni im, doktor i mjekësisë, as familja ime katolike nuk më përgatitën në rrugën shpirtërore. Kjo ndodhi jo pse nuk besoja në Zot, por pse mësimet e krishtera, në veçanti ato katolike, nuk më lejonin të ndieja ekzistencën e Zotit. Ndjenjat e mia si individ, ndaj Zotit, më ndaluan t’i besoja parimet e Trinisë (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë). Si pasojë e kësaj, nuk e pranova hyjninë e Krishtit.

Në atë kohë, krahas faktit se unë nuk kisha kurrfarë njohurie rreth Fesë Islame, isha njëri prej besimtarëve të Mono-teizmit, (besimit në një Zot). Ekziston vetëm një Zot, i Cili nuk ka shok. Kjo shprehet qartë në Kur’anin e Shenjtë, në suren El-Ihlas:

“Në Emër të All-lahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshirëplotit!

Thuaj: “Ai është All-llahu, Një i Vetmi. All-llahu është mbrojtës i gjithkujt. Nuk ka lindur, as s’është i lindur. Askush Atij nuk i përngjan.”

Në fillim më duhet të them: E pranova Fenë Islame për shkaqe metafizike dhe medituese. Por, ka edhe arsye të tjera që më shtynë ta pranoj Islamit, e ato janë:

- Mospranimi i klerit që pretendon se ka fuqinë që t'i falë mëkatet në vend të Zotit, qoftë i lavdëruar. I refuzova kategorikisht ritet katolike, sepse ato janë pagane, me prejardhje nga popujt primitivë të cilët i adhuronin idhujt.

- Krishterimi nuk përshkruan asgjë për pastrimin para lutjes. Kjo më duket si një fyerje ndaj Zotit, i Cili na ka dhuruar shpirtin dhe trupin, për të cilët ne nuk kemi të drejtë të mos kujdesemi.

- Në të njëjtën kohë, më dukej se Islami i përshtatet naty-rës njerëzore. Por, arsyeja kryesore që më nxiti ta pranoj Fenë Islame është Kur'ani i Madhërueshëm.

E studiova Kur'anin me shumë kujdes, para se të bëhem musliman, dhe atë studim e bëra me shpirtin kritik të një inte-lektuali perëndimor. Më duhet të përmend edhe veprën monu-mentale “Le Phenomene Coranique” (Fenomeni Kur'anor)<sup>1</sup> të Malik Ibn Nebiut, vepër e cila më bindi se Kur'ani është Shpallje e Zotit.

Janë disa ajete të veçanta në Kur'an që iu shpallën Muhammedit (a.s.), katërmëdhjetë shekuj më parë, të cilat dukeshin si gjëra të pabesueshme, por shkencëtarët më të njohur bashkëkohorë i provuan dhe gjatë hulumtimeve të tyre zbuluan se ato janë të vërteta.

Kur'ani më bindi të besoj në pjesën e dytë të Fjalës së Dëshmisë, se Muhammedi (a.s.) është i Dërguar i Zotit. Kjo qe arsyeja që unë u paraqita në Xhaminë e Parisit, Francë, dhe deklarova se po bëhem musliman. Me ndihmën e imamatit të xha-misë u regjistrova në listën e muslimanëve. Zgjodha një emër islam dhe tani quhem Ali Selman.

---

<sup>1</sup> Libri në fjalë është përkthyer në gjuhën shqipe nga dr. Feti Mehdiu.

Jam shumë i lumtur në Fenë Islame. Edhe një herë dekla-roj:

“Dëshmoj se s’ka zot tjetër veç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Tij.”

## **MIJËRA FRANCEZË E PRANUAN ISLAMIN**

Agjencia Franceze e Lajmeve (AFP) kohëve të fundit raportoi se në Francë Islami po përhapet me shpejtësi të madhe. Kjo agjenci njoftoi se 30.000 deri më 50.000 francezë të strukturave të ndryshme e të besimeve të ndryshme pranuan Fenë Islame. Bazuar në njoftimet e kësaj agjencie, Kisha Kato-like jo vetëm që po shqetësohet për shkak të numrit të madh të besimtarëve të rinj muslimanë, por ajo po befasohet nga besimi i thellë i francezëve të konvertuar në Fenë Islame dhe po kërkon e hulumton shkakun pse anëtarët e saj po largohen nga Katolicizmi.

Si shkak i këtyre zhvillimeve, të kalimit masiv në Islam, shumë gazeta e revista franceze po rezervojnë faqe të tëra për ta diskutuar këtë çështje.

“Revista Katolike” (Revue Catholique), një revistë e rëndësishme e katolikëve francezë, publikoi një studim të gjithan-shëm rreth këtij subjekti dhe vuri në dukje se besimtarët e rinj islamë dallojnë nga të konvertuarit e mëhershëm.

Në të kaluarën, numri i të konvertuarve që e pranonin Fenë Islame ishte i kufizuar dhe asokohe ishin vetëm ushtarakë. Në Afrikën Veriore dhe në Lindjen e Mesme, në kohën e kolonializimit francez, përveç ushtarëve dhe oficerëve francezë, Fenë Islame e kishte pranuar edhe Gjenerali

Minean, komandanti kryesor i armatës franceze në Egjipt, pas ekspeditës së Napoleonit, në fillim të shek. XIX.

Përkundrazi, sot besimtarët e rinj muslimanë janë intelektualë të shquar perëndimorë, të cilët kanë studiuar Kur'anin dhe filozofinë islame. Ndër ta duhet përmendur: Rene Jeneon, mendimtar i njohur, Roger Garoudy, filozof i shquar, Michel Chorkioutz, artist dhe Maurice Begart, specialiste, të cilët e pranuan Islamin sepse kjo fe, sikur dëshmojnë edhe vetë, ndikoi me thjeshtësinë dhe me gjallërinë e saj për t'iu afruar Zotit pa ndërmjetës.

Të gjithë këta besimtarë të rinj muslimanë thonë se arsyet kryesore për ndërrimin e fesë është se:

Feja Islame u ofron solidaritet besimtarëve dhe parimet e saj janë tepër tërheqëse, e sidomos vlerat morale. Në Fenë Islame besimtarët e rinj francezë gjetën paqen, që u mungonte në Katicizëm.

Kështu, besimtarët e rinj muslimanë francezë po i ndjekin dhe po i zbatojnë mësimet islame dhe po jetojnë në mënyrën islame pikërisht në zemër të Evropës! E ne, ku jemi?!

## **HATEM HOURI, GAZETAR (BEJRUT, LIBAN)**

Vlerat shpirtërore të Fesë Islame po i përshtaten natyrës njerëzore edhe në këtë kohë të zhvillimit spektakular dhe arritjeve të larta shkencore. Thirrjes Islame po i përgjigjen po-zitivisht individë e

grupe të tëra nga të gjitha anët e botës. Këto ditë, listës së gjatë të besimtarëve muslimanë iu shtua edhe një libanez nga Bejruti, kryeqytet i Libanit.

Hatem Houri, me profesion gazetar dhe pronar i një agjencie të lajmeve (Arab News Agency), deklaroi se e pranoi Fenë Islame. “Arsyet kryesore që ndikuan që ta pranoj Fenë Islame - thotë ky musliman i ri - janë: Vlerat e larta të Islamit të cilat të udhëzojnë në rrugë të Zotit, që të përpiqesh për drejtësi e liri.

Isha i krishterë dhe porsa e kuptova se Krishtërimi është bërë mbulesë e kryqëzatave të reja për kolonizimin e popujve, sikurse edhe qëllimi i cionistëve, u paraqita në Zyrën e Vëllazërimit Arab (The Arab Brotherhood Office) në Bejrut dhe deklarova me gojë e me shkrim se e pranoj Fenë Islame.”

Hatem Houri, në deklaratën e tij me shkrim se e përqafton Islamin, shënoi: “Ngase jam besimtar i Fesë Islame dhe i Mesazhit të Pejgamberit Muhammed (a.s.), që është Vula e Pejgamberëve, deklaroj se e pranoj Islamin. Dëshmoj se s’ka zot tjetër përveç All-llahut, se Muhammedi (a.s.) është i Dërguari i Tij dhe se Feja e Vërtetë tek All-llahu është Islami.”

Kjo deklaratë e thjeshtë, siç është e thjeshtë edhe Feja Islame e besimtarit të ri Hatem Hourit, për pranimin e Islamit bëhet në praninë e dy dëshmitarëve të quajtur: Muhammed El Faituri, përfaqësuesi i “The Arab Brotherhood Office” dhe Tahir Al Arabi, përfaqësuesi i Institutit Arab për Zhvillim nga Bejruti.

Vëllait të ri në besim i urojmë paqe, fatbardhësi, përparim e lumturi!

## DONALD S. ROCKWEL, POET, KRITIK LETRAR (SHBA)

Rrezet e Dritës së Vërtetë, rrezet e Fesë Islame, po depërtojnë në çdo skaj të botës, bile edhe në shtetin më të zhvilluar, më të fuqishëm e më demokratik, siç e konsiderojnë veten Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Listës së gjatë iu shtua edhe një musliman amerikan me emrin Donald S. Rockwell, i cili është poet dhe kritik i njohur letrar në Amerikë.

Për ç'arsye e pranoi Fenë Islame ky i konvertuar amerikan, tregon deklarata e tij të cilën e botoi shtypi amerikan, dhe ai i Lindjes së Mesme.

Muslimani i ri amerikan, Donald S. Rockwell, thotë:

“Janë disa arsye themelore që më tërhoqën ta pranoj Fenë Islame, por më kryesoret janë: thjeshtësia, atmosfera e qetë që mbizotëron nëpër xhami, besnikëria e besimtarëve muslimanë, frymëzimi i tyre dhe besimi që ata kanë në All-llahun, të Cilit i përgjigjen pesë herë në ditë, posa e dëgjojnë ftesën (ezanin) për lutje (namaz).

Kur vendosa të pranoja Islamin, zbulova arsye të thella që i vërtetojnë këto fenomene, ndërmjet të cilave është thjeshtësia e jetës së Pejgamberit Muhammed (a.s.), i cili këshillohej me bashkëpunëtorët e tij, ndezi dashurinë e mirësinë ndër bashkëkohasit, i rregulloi të drejtat e grave etj.

Këto mësimet e porosi, si dhe shumë të tjera, më bindën ta pranoja Fenë Islame. Muhammedi (a.s.) erdhi me një fe e cila është sistem i përsosur për një jetë të natyrshme, e jo besimi i verbër...

Toleranca e Fesë Islame ndaj besimeve të tjera e bën për vete çdo kërkues e gjurmues të lirisë e të së vërtetës. Muhammedi (a.s.) i urdhëronte besimtarët muslimanë, siç porosit Kur’ani, që

besimtarët hebrenj dhe të krishterë (Ehli Kitab), pra ata që i kanë Librat hyjnorë, të nderohen në besimet e tyre! Kjo porosi dhe ky nderim ndaj mësimëve të Abrahamit (Ibrahimit), Mojsiut (Musaut), Krishtit (Isait), paqja e shpëtimi i Zotit qofshin mbi të gjithë ata si të Dërguar të Zotit, pa dyshim është një cilësi superiore në krahasim me religjionet e tjera.

Çlirimi e pastrimi absolut nga idhujtaria është një argument që shpreh fuqishëm pastërtinë dhe madhështinë e Fesë Islame. Mësimet e Muhammedit (a.s.) nuk udhëhiqen nga flaka e fanatizmit, por nga drita e arsyes. Kur'ani, Libri i Shenjtë, qëndron i pandryshuar që nga koha e Muhammedit (a.s.), kur iu zbulua, pa iu ndryshuar asnjë shkronjë, asnjë shprehje, asnjë fjalë! Kujdesi për shëndetin personal e shoqëror si dhe pastërtia ishin disa prej porosive kryesore të Pejgamberit të dashur...

Kur i vizitoja xhamitë në Stamboll, Damask, Jerusalem, Fes, Algjer dhe në qytete të tjera të vendeve islame, më kaplonte një ndjenjë e fuqishme për Fenë Islame, sepse thjeshtësia e tyre përmbushte praninë Hyjnore më tepër se çdo rit, pikturë, skulpturë ose muzikë që kanë tempujt e tjerë...

Unë gjithmonë jam magjepsur nga Demokracia Islame. I varfri dhe i pasuri janë në një rrafsh në obligimet fetare, në namaz, para Zotit, në xhami, ku i luten Atij, e adhurojnë, i nën-shtrohen vullnetit të Tij me përvuajtje, etj.

Muslimanët nuk e pranojnë ndërmjetësinë ndërmjet njeriut si krijesë dhe Zotit si krijues, as rrëfimin ose të rrëfyerit.

Muslimanët Zotin e quajnë Krijues Fuqiptotë të Gjithësisë dhe Burim të Ekzistencës, pra nuk pranojnë ndërmjetës nga prijësit fetarë ose të tjerë.

Vëllazërimi i besimtarëve, humaniteti, solidariteti pa dallim ngjyre, race a gjinie, janë disa nga arsyet kryesore që më inkurajuan në pranimin e Fesë Islame.

## **FADLULLAH WILMONT, HISTORIAN (AUSTRALI)**

Religjioni në shumë vise të Australisë, ku unë kam lindur, nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në jetën e njerëzve. Shumi-ca e banorëve të saj janë ateistë. Në këtë mjedis jam rritur.

Kur i fillova studimet në universitet lexova disa libra shkencorë. Njëri prej tyre ishte vepër e autorit frëng, La Come de Llet, në të cilën shtrohej një çështje jetësore: A është e mundshme që jeta të ketë filluar rastësisht? Ky libër më vuri përballë kësaj pyetjeje: Si filloi jeta? Deri atëherë nuk besoja në asnjë religjion, por fillova të mendoj se përveç krijimit duhet të ekzistojë edhe një fuqi e madhe, e kjo fuqi është ajo e Zotit.

Më vonë u detzrova të largohem nga fshati dhe u vendosa në kryeqytet, ku edhe fillova të punoj në një bankë. Në atë kohë banoja në një familje të krishterë, në të vërtetë shpirtë-rishtë religjioze.

Në këtë familje fillova të mësoj e të ndiej se religjioni vërtet ekziston dhe se qenka e nevojshme që njeriu të jetë fetar. Feja e përmirëson njeriun, sjelljet e tij dhe njëkohësisht e furnizon me kënaqësi psikologjike. Të gjitha këto ndikuan dhe u bëra i krishterë. Përpiqesha të isha i krishterë

sa më i mirë. Fillova të shkoj në kishë, të lutem dhe isha shumë aktiv në aktivitetet e krishtera. Fillova ta studioj thellësisht krishtëri-min, por derisa lexova librin “Commentaries on the Bible”, i cili shpjegon çdo gjë që thuhet në Bibël. Gjatë leximit vura re shumë kundërthënie. Aq më tepër, shumë shkrimtarë të krishterë që kanë shkruar rreth ungjijve dyshojnë në autenticitetin e tyre. Por, unë megjithatë e adhuroja Krishtërimin dhe nuk u kushtoja rëndësi të veçantë këtyre shkrimeve...

Fati deshi që të fitoja një bursë universitare, që ta studioja historinë. Fillova me studimin e Rilindjes Evropiane, si hyrje e studimit të Historisë Moderne Evropiane. Prej këtij studimi mësova se sa i madh ishte ndikimi i mendimit arabo-islam në mendimin evropian. Por, si e pse? Cila ishte arsyeja e këtij ndikimi? Kjo nuk shpjegohej në hollësi! Ky qe shkak që unë fillova të hulumtoj e të kërkoj prejardhjen e këtij ndikimi.

Me seriozitet fillova gjurmimet dhe hulumtimet shkencore. Si fryt i këtij hulumtimi, zbulova se muslimanët ishin ata që e nxorën Spanjën nga errësira e Mesjetës. Po të mos ishin muslimanët në Spanjë, Evropa sot e kësaj dite do të mbetej si në kohën e Mesjetës! Dijetari frëng Zhirardi, i cili kishte studiuar në Universitetin Islam të Kordobës, në Spanjë, pasi u kthye në Francë, ishte edhe këshilltar i Papës në Romë. Zhirardi, gjatë qëndrimit në Kordobë i studioi numrat arabë, siç quhen nga evropianët. Deri në atë kohë evropianët përdornin numrat romakë, të cilët nuk ishin aspak praktikë, p.sh., nëse dëshironi të shumëzoni 99 x 999 me numrat romakë, do t’ju duhej një faqe e tërë...!

Mendja arabe e zbuloi zeron. Ky zbulim ishte guri themeltar i shkencës matematikore. Zhirardi ishte i pari që i vuri në zbatim zeron dhe numrat arabë, kuptohet, në Evropë. Pa zeron dhe pa

numrat arabë nuk do të ishte e mundshme të zhvillohej matematika moderne. Pra, sikur të mos ishin zbuluesit muslimanë-arabë, ndoshta do të ishim ende në errësirën e Mes-jetës...

Algjebra ishte një shkencë e pastër arabe, siç ishte edhe shkencë e llogaritjes, e zbuluar nga muslimanët. Pra, duket qartë se matematika, algjebra e llogaritja janë zbulime islame.

Edhe mjekësia që praktikohet sot në Evropë, bazohet në veprat e Ibn Sinasë dhe të Raziut, të cilat edhe sot e kësaj dite studiohen në Universitetin e Sorbonës, sepse janë tejet të dobishme. Muslimanët-arabë gjithashtu e zbuluan qarkullimin e gjakut rreth 400 vjet para Perëndimit!

E gjithë ajo që njihet me emrin Zbulime Shkencore të Rilindjes Evropiane është marrë nga përkthimet latine që kanë bërë muslimanët. Prandaj, këto nuk janë zbulime moderne, por janë rizbulime. Roxher Bakeni, i cili njihet si themelues i shkencës empirike, tha: “Nuk keni mundësi ta njihni shkencën përderisa nuk e mësoni gjuhën arabe!” R. Bakeni e mësoi metodën empirike nga muslimanët. F. Magelani, i cili ishte i pari që dëshmoi se Toka është e rrumbullakët, u bazua në studimet islame të botuara në Spanjë. Bile edhe kapiteni i anijes së Magelanit, ishte musliman nga Afrika. Nuk e teprojmë nëse themi se dituritë në të cilat bazohet shkencë moderne kanë ardhur kryesisht nga shkencëtarët muslimanë.

Jo vetëm kaq, por edhe marrëdhëniet shoqërore: bujaria, fisnikëria dhe respekti i veçantë ndaj femrës u sollën në Evropë nga arabët, nga rajoni i quajtur Provansë, që shtrihet ndërmjet Francës e Spanjës, prej nga u përhapën në tërë Evropën.

Koncepti i sigurimit për dëmshpërblim u bë i njohur në Evropë nga muslimanët arabë. Edhe çeçet e bankave pikësëpari filluan të përdoren nga muslimanët.

Në astronomi, Ibën El-Hithami ishte astronomi i parë që e zbuloi astrolabin. Të gjitha këto që u përmendën janë vetëm një pjesë e vogël e asaj që zbulova gjatë studimeve të mia për Evropën moderne. Edhe vetë çuditësia dhe pyetja i habitur: Kush janë muslimanët? Asgjë nuk dija për Fenë Islame e as për muslimanët. Kështu, hulumtimet e mia i fillova që nga fillimi.

Nga enciklopedia mësova se muslimanët janë ata të cilët i përkasin Fesë Islame dhe se kanë një libër të shenjtë që thirret Kur'an. Në bibliotekën e Universitetit ekzistonte një përkthim i mirë i Kur'anit të Madhërueshëm, të cilin e mora dhe fillova ta studioj me shumë vëmendje e kujdes.

Gjatë studimit zbulova këto tri pika kryesore, të cilat më lanë përshtypje të thellë. Ato janë:

1. Në Kur'an nuk ka kundërthënie, si në librat e feve të tjera.
2. Në Kur'an, në përmbajtjen e tij, nuk haset në asnjë kundërthënie me arritjet shkencore.
3. Kur'ani përfshin kryesisht çdo aspekt të jetës.

Pastaj fillova të studioja jetëshkrimin e Muhammedit (a.s.). Lexova disa libra rreth jetës së Pejgamberit. Studimet e mia zgjatën pesë vjet.

Në lagjen ku jetoja banonin edhe tre arabë muslimanë. Gjatë muajit të Ramazanit ata agjëronin e unë habitesha. Një ditë i pyeta: “Përse po e torturoni veten?” Ata ma dhanë këtë përgjigje të logjikshme: “Ne agjërojmë jo për ta torturuar veten, siç thoni ju, por për shumë arsye... Problemi kryesor i njeriut sot është vetëkontrolli! Zoti na ka dhuruar shumë mundësi... Agjërimi na mëson gjërat më të rëndësishme që na i ka falur Zoti. Thika, për shembull, përdoret në kuzhinë për përgatitjen e ushqimit dhe për gjëra të tjera, por edhe për ta vrarë veten ose dikë tjetër. Pra, varet

si e përdor, për të mirë a për të keq. Agjërimin ne e bëjmë për të mirë, që t'i përkryejmë dhe t'i zhvillojmë mundësitë tona. Sidomos vetëkontrollin..." Kjo përgjigje ishte vërtet e logjikshme. Pas kësaj ngjarjeje, që më la përshtypje të thellë, miqësia ime me këta muslimanë zhvillohej e rritej për çdo ditë!

Një ditë, njëri prej tyre m'u drejtua me këto fjalë: "A e di se je bërë musliman?" U befasova dhe menjëherë e pyeta se përse ma bënte këtë pyetje "Po, - më tha - a nuk e beson Kur'-anin?" "Po, e besoj" - i thashë. Më pyeti: "A nuk beson se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut?" "Po" - iu përgjigja duke i thënë se një libër si Kur'ani s'mund të sjellë askush pa qenë i Dërguar i Zotit ! Miku im më tha: "E gjithë kjo të bën të kuptosh se je bërë musliman!" U ktheva në shtëpi dhe u mbylla aty për një kohë të gjatë. Ndjeva që drita e besimit kishte filluar të më ndriçojë dhe All-llahu i Madhërueshëm të më udhëzojë.

I mësova lutjet, namazin. Erdhi muaji i Ramazanit dhe Zoti më dha vullnet që të agjëroj.

Ky ishte fillimi. Në këtë fillim zbulova se Feja Islame është e thjeshtë dhe e kuptueshme, prandaj edhe e pranova. Më vonë shkova në Indonezi si ligjërues universitar. Atje mësova edhe më shumë.

Tani, më në fund, e them me sinqeritetin më të thellë: E falënderoj All-llahun që më ndihmoi ta gjej të vërtetën dhe jam i sigurt se s'ka të vërtetë tjetër përveç Fesë Islame. S'ekziston rrugë tjetër shpëtimi për njerëzimin veç Fesë Islame. Ndiej se Islami është e VËRTETA!

## ANTONIO CARIOVATO, FILOZOF (ITALI)

Quhej Antonio Cariovato, 29 vjeç, italian nga Roma. Pasi e pranoi Fenë Islame, pas një studimi serioz, ndërroi emrin dhe tani quhet Salah Eddin. Ka kryer filozofinë dhe është speciali-zuar në të, por të Vërtetën e gjeti në Fenë Islame.

Rrjedh nga një familje konservatore italiane. Të gjithë anëtarët e familjes së tij shkojnë rregullisht në kishë, u binden rregullave të Kishës Katolike dhe po ato rregulla i zbatojnë në praktikë. “Kështu veproja edhe unë - thotë Antonio Cariovato – derisa zbulova se në Krishtërim ka shumë kundërthënie, hipo-krizi e mashtrime...! Për natyrën e Jezu Krishtit dhe jetën e tij ka disa shpjegime. Disa thonë se Jezusi (paqja e shpëtimit i Zotit qofshin mbi të), është djalë i Zotit, kurse disa të tjerë thonë se ai është vetë Zoti, por në pamjen e njeriut etj. Mirëpo, logjika s’e pranon asnjërën nga këto shpjegime. Provova të mësoj se ç’thotë Feja Islame. E lexova Kur’anin e Shenjtë dhe aty gjeta një përgjigje të arsyeshme, bindëse. E falënderova Zotin! Ky ishte hapi im i parë drejt Islamit. Duke e lexuar Kur’anin e Shenjtë zbulova atë që e ruaja në shpirt. Vendosa të bëhem musliman.

Fillova të mësoj se si të falem. I mësova lutjet, e në fillim e mësova kaptinën El-Fatiha. Familja ime në fillim, e sidomos babai dhe vëllezërit, gati të gjithë më kundërshtonin me shumë rreptësi, por unë vazhdoja rrugën time. Nuk pija më verë, u largova prej të gjithëve që luanin bixhoz, që e konsumonin alkoolin dhe bënin punë të tjera të ndaluara, haram.

Kur më shihnin duke marrë abdest e duke u falur pesë herë në ditë, para Zotit të Madhërueshëm, më pyetnin me habi se ç’po bëja? U thosha se po kryeja obligimet fetare...

Çështje më me rëndësi, në familjen time gati të gjithë filluan t'i vërenin ndryshimet në sjelljet e mia dhe nuk më kundërshtonin si më parë, por filluan në heshtje t'i pranonin veprimet e mia e nuk shqetësoheshin më. As unë nuk shqetësohe-sha prej tyre! E falënderoj Zotin! Tani të gjithë në familje kanë një simpati ndaj meje dhe po e respektojnë besimin që e kam zgjedhur. Feja Islame ka moral të lartë dhe i përkrah fuqimisht marrëdhëniet familjare e njerëzore.

Shpresoj se Zoti do të më ndihmojë që edhe familja ime në të ardhmen ta pranojë Islamin dhe i lutem të Madhit Zot që kjo dëshirë të më realizohet së shpejti...! Ai ka mundësi të bëjë çdo gjë!”

Muslimani i ri italian, filozofi Antonio Cariovato, tani me emrin e ri Salah Eddin, është i martuar dhe bashkëshortja e tij quhet Ajshe. Gjashtë muaj para se të martoheshin ajo pranoi Islamin. Ata ishin kolegë të mirë, të dashur e të sinqertë. I shprehnin njëri-tjetrit ndjenjat e brendshme shpirtërore. Dhe si rezultat i të gjitha këtyre bisedave edhe ajo filloi të interesohej për Fenë Islame. Filloi të mësojë, të lexojë, të studiojë e të krahasojë dhe më në fund All-llahu i Plotfuqishëm e udhëzoi, e ndriçoi, kështu që edhe ajo e pranoi Islamin!

“Lavdi të Madhit Zot, jeta jonë bashkëshortore”, - thotë plot gëzim z. Salah Eddin, - është e lumtur dhe plot mirëkuptim. Gruaja ime, Ajshja - vazhdon z. Salah Eddin, - e di se duhet t'i bindet Zotit, kuptohet edhe burrit. Unë, gjithashtu, i di të drejtat e gruas, të cilat ajo i gëzon në Fenë Islame... E kundërta po ndodh në shoqërinë evropiane.

Shkurt e me pak fjalë mund të themi: E gjetëm veten në Islam. E ndiejmë paqen e sigurinë, prej se jemi bërë muslima-në. Vërtet, jeta jonë tani ka kuptim! Të gjitha këto na mungo-nin dhe iu mungojnë njerëzve në shoqërinë moderne evropiane. Ky civilizim materialist po e bënë njeriun frikacak, të pasigu-rtë, të shqetësuar dhe të hutuar... Vetëm besimi i drejtë në All-llahun e Plot-

fuqishëm mund ta ndryshojë këtë gjendje të mjerueshme, vetëm me besim njeriu mund të jetojë në paqe në këtë botë.

Edhe gruaja ime ndihet dhe shprehet pothuajse në të njëjtën mënyrë. Feja Islame na mësoi dhe na obligoi të falemi pesë herë në ditë. Pesë herë në ditë të takohesh me All-llahun e Madhërueshëm është një gëzim i papërshkrueshëm.

Në çdo namaz më kthjellohet mendja, më qartësohet besimi dhe më qetësohet shpirti. Kjo mund të gjendet vetëm në Islam. Me të vërtetë, ne zbuluam shumë mirësi në këtë fe të vërtetë.”

## **JOHN WEBSTER, FILOZOF (ANGLI)**

Kam lindur në Londër dhe jam rritur e edukuar si i krishterë, por me bindje protestante. Në vitin 1930, si çdo i ri, fillova të ballafaqohem me problemet e jetës dhe në këtë kohë i vëreja dobësitë e Krishterimit.

Krishterimi është një dualizëm i cili e paraqet botën si mëkatore dhe kërkon ta kthejë realitetin e jetës duke i projektuar shpresat në një botë të ardhshme.

Më tepër emocional sesa racional, nën ndikimin e entuziazmit rinor, refuzova Kishën (protestante), Krishterimin dhe u bëra komunist. Komunizmi deri diku më solli kënaqësi, por, për shkak të materializmit e refuzova edhe këtë. Më vonë fillova të studioj filozofinë dhe religjionin...

Gjatë kohës që jetova në Australi, u interesova të gjej Kur'anin e Shenjtë në Bibliotekën Publike të Sidneit. Nuk gjeta asnjë përkthim të bërë nga muslimanët. Disa javë më vonë, në qytetin e Pertit, Australia Perëndimore, përsëri e kërkova Kur'anin e përkthyer nga ndonjë musliman dhe e gjeta.

Nuk mund ta shpreh me fjalë, as ta përshkruaj, atë ndryshim të përnjëhershëm që më ndodhi kur lexova suren El-Fatiha, shtatë ajetet e para të Kur'anit...! Lexova edhe disa faqe të tjera rreth jetës së Muhammedit (a.s.). Në librari atë ditë i kalova disa orë, por me mëshirën dhe ndihmën e Allahut e gjeta atë që po e kërkoja që sa kohë. U bëra musliman! Deri në atë moment unë ende nuk kisha takuar ndonjë musliman. Kur dola nga libraria e ndjeva veten shumë të lodhur e të tronditur, nga pikëpamja emocionale dhe intelektuale, si pasojë e asaj që përjetova në librari duke lexuar vetëm një sure të Kur'anit dhe disa faqe rreth jetës së Pejgamberit (a.s.). Menjëherë e pyeta veten: “Ishte e vërtetë apo ëndërr ajo që lexova, ajo që më transformoi menjëherë?!”

Dola nga libraria me qëllim që të pi një kafe diku dhe të pushoj pak. Duke ecur rrugës, për ku isha nisur, më shkuan sytë në një ndërtesë ku shkruante: “Muslim Mosque” (Xhamia e Muslimanëve). Aty për aty i thashë vetes: “E njeh të Vërtetën, pranoje!” Me mëshirën e Allahut u bëra musliman.

Dëshmoj se s'ka zot tjetër veç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi (a.s.) është i Dërguari i Tij.”<sup>2</sup>

## **FATIME KAZUEI (TOKIO, JAPONI)**

Japonezët atdheun e tyre, të cilin e duan shumë, e quajnë Nipon, që në gjuhën shqipe do të thotë: Vendi i lindjes së Die-llit. Por, në Japoni po shndrit një Diell tjetër, rrezet e të cilit po i ngrohin zemrat dhe po i ndriçojnë shpirtat e qindra, mijëra japonezëve, në çdo skaj të vendit të tyre aq të zhvilluar ekonomikisht dhe me teknologji aq të sofistikuar. Është ky diell, Dielli i Fesë Islame...!

Sivjet u mbushën 108 vjet nga ajo ditë e bekuar kur një japonez pati pranuar Fenë Islame, më 1896, që shënohet si një ditë me rëndësi historike në Japoni! Sipas Ebu Bekër Morimotus, historian, ekspert për historinë islame në Japoni, japonezi i parë që e kishte pranuar Fenë Islame ishte Hachiro Ariga, i cili ishte bërë musliman në vitin 1896, në Bombai, Indi. Kurse ha-xhiu i parë nga Japonia, që kishte shkuar për vizitë në vendet e shenjta, Mekke dhe Medine, sipas urdhrat të Krijuesit të Gjithë-sisë, ishte një djalosh 29 vjeçar dhe quhej Umer Jamavika. Ky haxhi, i pari në Japoni, e kishte vizituar Kaben e Bekuar dhe kishte bërë ibadet aty në vitin 1909.

---

<sup>2</sup> Shënim: Anglezi John Webster, pasi u ndriçua me Dritën Islame nga All-llahu, siç dëshmoi vetë, ndërroi emrin dhe tani quhet Muhammed Webster. Është kryetar i Misionit Musliman Anglez (The English Muslim Mission).

Në Japoni, për nevojat shpirtërore dhe për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme fetare-kulturore, u ndërtua edhe xhamia e parë që në vitin 1935, në qytetin Kobe, kurse tre vjet më vonë, më 1938 u hapën themelet e xhamisë së kryeqytetit, Tokios.

Në vitin 1941, pasi shumë të rinj japonezë kishin pranuar Fenë Islame, rinia islame e këtij vendi e pa të dobishme të organizohen dhe kështu e themeluan Shoqatën e Studentëve Muslimanë. Më vonë u themeluan edhe shoqata e qendra islame nëpër qytete të ndryshme, ku të gjitha kishin të njëjtin qëllim: përhapjen e Fesë Islame në Japoni. Këta besimtarë japonezë me punën, sjelljen e shembujt personalë po ndikojnë në popullatën japoneze dhe kanë suksese të vazhdueshme në përhapjen e Fesë Islame. Si fryt i kësaj veprimtarie të organizuar, për çdo ditë po shtohet numri i besimtarëve muslimanë japonezë, të cilët vijnë nga shtresa të ndryshme të shoqërisë japoneze: ka studentë, punëtorë, intelektualë të lëmenjve të ndryshëm dhe ndonjë shkencëtar!

Listës së gjatë të të konvertuarve iu shtua edhe një zonjushë japoneze, e cila, pasi e pranoi Fenë Islame, e ndërroi emrin dhe tani quhet Fatime Kazuei. Kjo zonjushë e ndershme, pasi u bë muslimane dhe e përqafoi Islamit, dha këtë deklaratë:

“Pasi filluam të pranojmë stilin amerikan të jetesës, edhe unë ndjeva se diçka po më mungonte, po më shqetësonte... Në fillim nuk e kisha të qartë se ç’më mungonte, ç’më shqetëson-te. Ishte ky qëllimi i pastër që kisha në shpirt që më dha përgji-gjen ndaj këtij shqetësimi...!

Isha fatlume që u njoha me një besimtar musliman, i cili banonte përkohësisht në Tokio. Sjellja e tij e shkëlqyeshme dhe mënyra e adhurimit ndaj Zotit më la përshtypje të thellë dhe u bëra kureshtarë, aq sa u detyrova t’i shtroja shumë pyetje. Përgjigjet e tij ishin të sakta, të drejta, të kënaqshme dhe aq bindëse, saqë më transformuan menjëherë! Ky transformim më solli një qetësi,

rehati, në mendje e në shpirt! Kurrë nuk kam menduar, e as që do të besoja, se jeta ime do të ndryshonte aq shumë dhe aq shpejt, ashtu siç ndodhi me mua kur fillova të jetoj si besimtare muslimane...”

Përshtypje të veçantë zonjushës Fatime i ka lënë përshëndetja islame “Es-Selamu Alejkum”, për të cilën thotë: “Shiko si përshëndeten muslimanët: “Es-Selamu Alejkum ue Rahmetull-llahi ue Berekatuhu” (Paqja, Mëshira dhe Bekimi i Zotit qofshin mbi ju). Kjo përshëndetje nuk u ngjason atyre të tjerave si “mirëmëngjesi” a “mirëdita” që i ka bota, të cilat kufizohen me mëngjesin ose me një pjesë të ditës dhe kanë vetëm kuptim materialist. Këto përshëndetje nuk përmbajnë ndonjë urim ose dëshirë të përhershme dhe as që kanë ndonjë lutje ndaj Zotit për bekim...!

Nga miku im musliman unë mësova shumë gjëra të dobishme, si nga ana teorike ashtu edhe nga ajo praktike, që të jem një besimtare e devotshme. Unë e dua shumë mënyrën islame të jetesës, jetesë e cila është e pastër, e thjeshtë dhe kryesisht paqedashëse!

Jam plotësisht e bindur se vetëm Feja Islame mund të sjellë paqe, paqe për çdo njeri, për çdo shoqëri. Vetëm Feja Islame mund t'i sjellë paqe mbarë botës, për të cilën njerëzimi ka aq shumë nevojë.”

Në fund të deklaratës, zonjusha Fatime thotë:

“Jam shumë e lumtur që po e gëzoj këtë paqe dhe po përpiqem, aq sa kam mundësi, ta përhap Fenë Islame në Japoni, në mesin e popullit tim...”<sup>3</sup>

## **MARGARET MARCUS, SHKRIMTARE (NJU-JORK, SHBA)**

“E kush kërkon fe tjetër përveç Fesë Islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.” (Kur’ani, 3:85)

Me këtë ajet nga Kur’ani i Madhërueshëm, që është Fjala e All-llahut, e fillon librin e saj me titull Islam and Modernism (Islami dhe Modernizmi), ish-studentja amerikane e Universitetit të Nju-Jorkut, zonja Merjem Xhemileh, libër që bëri jehonë e që u botua në gjuhën angleze në qytetin Lahore të Pakistanit.

Kush është zonja Merjem Xhemileh? Zonja Merjem Xhemileh është një e konvertuar amerikane, autore e rreth dyzet librave. U lind nga prindër amerikanë, me prejardhje gjermane-hebraike, në Nju-Jork, në vitin 1934. Si nxënëse, e më vonë edhe si studente në Universitetin e Nju-Jorkut,

---

<sup>3</sup> Shënim i përkthyesit: Motrat shqiptare, veçanërisht nga brezi i ri, me emra të huaj që s’ua dinë as kuptimin, me veshje të shëmtuar, me sjellje të pahijshme e skandaloze, që po çoroditen çdo ditë nga ndikimi i shtypit, televizionit, nga kultura e degjeneruar perëndimore, për të pasur një jetë kuptimplote le të ndjekin shembullin e zonjushës japoneze, që nuk është rast i vetmuar... Vetëm me Fe, vetëm me Besim, jeta ka kuptim...!

dallohej prej të gjithëve me zgjuarsinë e seriozitetin e saj në mësimet e studime. Ishte adhuruese e madhe e librit, vazhdimisht lexonte, ngase ishte e pangopur për dituri.

Kur lindi, prindërit e saj e emëruan me emrin Margaret Marcus, por erdhi një ditë kur ajo e ndërroi emrin dhe fenë e saj. Rruga deri në agimin e asaj dite ishte e gjatë, e mundim-shme, përplojt dëshpërime e zhgënjime. Më në fund u bë ashtu siç dëshiroi i Madhi Zot: Feja Islame, Drita e saj, ngadhënjeu mbi errësirën e filozofisë, humanizmit ateist, materializmit, baha'izmit dhe cionizmit.

Në librin e lartpërmendur, “Islami dhe Modernizmi”, zonja Merjem Xhemileh përshkruan rrugën e vet jetësore në kapitullin e parë, me titullin: Përse e pranova Islamin? Një përshkrim interesant, prekës dhe frymëzues, ku ajo ndër të tjera thotë:

“Gjatë adoleshencës isha nën ndikimin e filozofisë humaniste. Kur fillova të përkryhem intelektualisht nuk kënaqesha më me ateizmin e kësaj filozofie. Pas një kohe iu bashkangjita grupit të baha'ive në Nju-Jork. Në fillim, Baha'izmi më dukej tërheqës, meqë edhe prejardhjen e kishte islame... Por, kur zbulova sesa keq kanë devijuar e dështuar, pas një viti u largova tejte e dëshpëruar prej tyre.

Në moshën 18-të vjeçare u bëra anëtare e lëvizjes fetare të quajtur “Mizrachi hatzair”, që ishte një lëvizje cioniste. Kur e kuptova natyrën e vërtetë të cionizmit, i cili nxit dhe farkon armiqësinë ndërmjet hebrenjve dhe arabëve, pas disa muajsh e braktisa këtë lëvizje dhe prej tyre u ndava e mërzhitur dhe e zhgënjyer.

Kur isha 20-vjeçe, e njëkohësisht studente në Universitetin e Nju-Jorkut, profesori im, Rabbi Abraham Isaak Katch, përpi-qej në çdo mënyrë të na bindte se Islami rrjedh nga Judaizmi! Aq më tepër edhe tekstet universitare, që ishin të shkruara prej tij, kishin atë përmbajtje dhe synonin atë qëllim, që stu-dentët të binden se Judaizmi është burim i Islamit dhe se është superior ndaj tij! Sa më përket mua, në vend që të më bindnin, fjalët dhe veprat e profesorit arritën efekt të kundërt!

Megjithëse kisha dëshirë që të bëhem muslimane që në atë kohë, pra kur isha studente 20-të vje-çare, pengesë e pakalueshme m'u bë familja. Ata më qortonin, më paralajmëronin se Feja Islame do ta ndërlikojë jetën time dhe se ajo fe nuk është si Judaizmi e Krishterimi, që janë pjesë e traditës amerikane. Më thoshin se Feja Islame do të më tjetërsojë dhe si pasojë e kësaj do të armiqësohem me familjen dhe do të izolohehem nga rrethi e komuniteti...

Besimi im në atë moshë nuk ishte aq i fortë sa t'u bëja ballë këtyre presioneve. Pjesërisht si rezul-tat i këtyre presioneve, pata një tronditje të brendshme, u sëmura rëndë dhe u detyrova t'i ndërpres studimet... Për afër dy vjet isha në depresion të thellë. Gjatë viteve 1957 - 1959, prindërit më vendosën në spitale private dhe shtetërore. Ndërsa qëndroja në spital, një ditë u betova: "Nëse ndonjëherë shërohem, përmirësohem dhe dal nga spitali, do ta pranoj Fenë Islame."

Deshi i Madhi Zot dhe gjendja shëndetësore e Margaretës u përmirësua dhe ajo doli nga spitali. Porsa doli nga spitali, filloi të hulumtojë nëpër Nju-Jork se ku mund të takojë besimtarë e be-simtare të Fesë Islame. Për fat të mirë gjeti ata që ishin ndër njerëzit më të mirë, për të cilët vetëm se kishte shpresuar se mund t'i gjente ndonjëherë.

Ndërkohë, ajo filloi të shkruajë për Fenë Islame dhe ta mbrojë atë nga akuzat e rënda që i bëheshin nga të gjitha anët, sipas direktivave të aleancës hebraiko-krishtere dhe qarqeve sekulla-

riste anti-islame. Botoi shumë punime e studime në revista islame dhe emri i saj u bë mjaft i njohur. Njëkohësisht, mbante korrespondencë me udhëheqësit më eminentë të rizgjimit islam në mbarë botën. Mbante letër-këmbime me Shejh Ibrahimin, lider i ulemave në Algjeri, dr. Muhammed e Al-Az'-harin, Egjipt, dr. Mahmud F. Hoballahun, drejtor i Qendrës Isla-me në Uashington, dr. Hamidullahun e Parisit, dr. Said Rama-danin, drejtor i Qendrës Islame të Gjenevës dhe me dijetarin e mirënjohur Mevlana Sejjid Ebul Ala Meududiun<sup>4</sup>, në Pakis-tan.

Betimin që kishte dhënë studentja Margaret Marcus sa ishte në spital, se nëse shërohet dhe lëshohet nga spitali do ta pranojë Fenë Islame, All-llahu (xh.sh.) ia kishte dëgjuar dhe ia reali-zoi. Ditën e Madhërueshme të Kurban Bajramit, në praninë e dy dëshmitarëve, studentja amerikane Margaret Marcus e tha me gojë e me zemër Fjalën e Dëshmisë: “Dëshmoj se s’ka zot tjetër veç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij” dhe kështu, pas Fjalës së Dëshmisë, ajo u bë muslimane edhe zyrtarisht.

Në Qendrën Islame në Bruklin, Nju-Jork, mori certifikatën me emrin e ri musliman, Merjem Xhemileh, të cilën ia lëshoi udhëheqësi i Qendrës, Shejh Daudi.

Merjem Xhemileh thotë se krenohet me emrin e ri musliman, sikurse edhe me Fenë Islame, të cilën e përqafoi me gjithë shpirt! Këtë e dëshmoi edhe me vepra, duke shkruar rreth dyzet libra...

Më në fund, zonja Merjem Xhemileh thotë:

---

<sup>4</sup> Për më gjerë shih: Letërkëmbimi mes Merjem Xhemiles dhe Ebu'l A'la el-Mevdudiut, Lidhja e Rinisë Islame, Shkup 1412/1992.

“Nuk e pranova Fenë Islame nga urrejtja ndaj të parëve të mi, ose ndaj popullit tim, por për mua kjo do të thotë kalim nga një fe që po jep shpirt dhe që është aq e kufizuar, në një fe dinamike e plot gjallëri... Feja Islame është e Vërteta Hyj-nore Universale, e cila vlen për çdo vend e për çdo kohë...”

## **SUZANNE HANEEF, GAZETARE (SHBA)**

Përkundër propagandës së paskrupullt e tepër të fëlliqur që po zhvillohet në Perëndim, me të gjitha mjetet e fuqishme dhe të sofistikuara kundër muslimanëve dhe Fesë Islame, megjithëkëtë muslimanët po shtohen dhe Feja Islame po gjallërohet duke përfituar çdo ditë anëtarë të rinj!

Ninian Smart, profesor i religjioneve në Universitetin e Kalifornisë, në Santa-Barbara, në lidhje me këtë i dha këtë deklaratë revistës më të njohur amerikane, të përjavshmes “TIME” (KOHA): “Është tradicionale paraqitja e shtrembëruar e Islamit në Perëndim. Aq më tepër, viteve të fundit po paraqitet edhe si terroriste...”

Por, kush po e kërkon të vërtetën nuk po e përfill fare këtë propagandë të filliqte... Virginia Martson, (tani quhet Kerima Omar Kameuneh, ish-anëtare e Kishës Episkopale) nga Burban-ku, Kaliforni, Ogen Davis nga Atlanta, Xhorxhi, dr. Stejf Xhonson, (tani quhet dr. Faruk Abdullah) dhe shumë të tjerë nuk i pengoi fare propaganda anti-islame për ta përçafuar të Vërtetën, Fenë Islame. Të konvertuarit amerikanë janë jo me dhjetë-ra, por me qindra e mijëra, bile edhe me tituj

të lartë shkencor. Por, ne veçuan në këtë rast një gazetare. Përse kjo gazetare amerikane e pranoi Fenë Islame?

Gazetarja amerikane, Suzanne Haneef (Hanif), e kërkoi të Vërtetën dhe e gjeti në Fenë Islame. Si gazetare ajo kishte mundësinë për të udhëtuar shumë dhe nëpër vende të ndryshme të botës islame. Ajo atje u njoh për së afërmi me muslimanët dhe me Fenë Islame. Në fillim nga kureshtja, e më vonë nga dashuria, ajo iu përkushta me gjithë shpirt studimeve për Fenë Islame dhe, më në fund, me ndihmën e All-llahut, u ndriçua me Dritën e saj dhe e pranoi Islamin, këtë fe të vërtetë, fe e cila po dëshmohej çdo ditë se po i përshtatet natyrës njerëzore, në çdo vend e në çdo kohë.

Muslimania e re amerikane, Suzanne Haneef, pasi e gjeti atë që e kërkonte - qetësinë shpirtërore, dëshironte që edhe të tjerët në Amerikë dhe kudo në botë ta kuptojnë e ta pranojnë këtë fe të përsosur. Si rezultat i kësaj dëshire të zjarrtë ajo shkroi një libër për Fenë Islame, i cili u botua në gjuhën angleze në qytetin Lahore të Pakistanit.

Gazetarja amerikane, pasi e falënderoi All-llahun e Madhërueshëm, i lutet Atij për mirëkuptim dhe udhëzim dhe për pranimin e Fesë Islame, ndër të tjera, thotë:

“Jetojmë në shekullin e ndërrimeve të mëdha e të shpejta dhe në pasiguri të plotë. Njerëzit janë shumë të shqetësuar. Megjithëkëtë, ka njerëz që po përpiqen të gjejnë rrugëdalje, që njerëzimi të shpëtojë nga kjo rrugë qorre ku është katan-disur. Është e vërtetë se sot po jetojmë në kohën kur përparimi dhe civilizimi materialist kanë arritur kulmin, por, njëkohësisht, cilësia e jetës, morali njerëzor, kanë rënë aq poshtë, sa që racës njerëzore po i afrohet kataklizma...

Feja Islame ofron zgjidhje! Vetë fjala Islam do të thotë Paqe, Bindje...! Kur besimtari jeton në paqe, dhe i bindet Zotit, i Cili është Një dhe i Vërtetë, atëherë Feja Islame ndikon intensivisht në mendimet dhe sjelljet e tij. Vetëm Zoti është Krijues, Sundues i Gjithësisë dhe njeriu vetëm Atij i përgji-gjet...

Feja Islame e udhëzon njeriun, e drejton kah përparimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm. Parimet e kësaj feje janë të arsyeshme, të dobishme për shëndetin fizik e psikik dhe i përshtaten plotësisht natyrës njerëzore.

Kjo fe nuk është vetëm një sistem fetar, një ideologji apo një religjon, siç jemi mësuar ta quajmë, por është tërësia e jetës së njeriut, është një sistem i gjithëmbarshtëm, gjithëpërfshirës, i cili të udhëzon, të drejton në çdo fushë të jetës, qoftë si individ, shoqëri apo bashkësi.

Përmes obligimeve fetare, të cilat i ka caktuar Zoti, marrëdhëniet në jetë kanë një optimizëm, një shpresë dhe përmes tyre krijohet një identitet i veçantë në dobi të vet-vetes, shoqërisë dhe natyrës.

Feja Islame në Amerikë dhe në Evropë kuptohet gabimisht, sepse si e tillë edhe prezantohet! Shumë njerëz në Amerikë mendojnë se kjo fe është ndonjë sekt apo ndonjë kult! All-llahu për ta është një hyjni pagane, kurse për Muhammedin (a.s.) kujtojnë se është një person që adhurohet nga paganët e tejetit, tejoqeanit...! Pse ndodh kështu?

Ndodh kështu sepse ka lënë pasoja e kaluara historike me plot paragjykime, kryqëzatat shekullore, propaganda e vazh-dueshme me qëllime të caktuara, hegjemonizmi e të tjera...

Por e vërteta është se Feja Islame njeriun si krijesë e liron nga prangat e sundimit material, nga epshet e shfrenuara shtazarake dhe e humanizon. Singërisht i lutem Zotit që të ma pranojë këtë përpjekje modeste dhe të më ndihmojë që edhe të tjerët ta kuptojnë Fenë Islame, e cila u sjell dobi dhe është e vetmja rrugë për paqe dhe shpëtim...”

## **PËRSE PRIFTI PROTESTANT, RABINI ÇIFUT DHE NJË GJYSHE GJERMANE E PRANUAN FENË ISLAME?**

Feja Islame është fe e mbarë njerëzimit, fe e shpallur nga i Madhi Zot, Krijues i çdo krijese. Është një fe pa mitologji, pa kler e pa hierarki. Mësimet e kësaj feje janë të përsosura, të thjeshta, të arsyeshme e të dobishme për të gjithë. Ato bazohen në Librin e Shenjtë, Kur’anin, i cili na mëson të lutemi: “O Zoti im! Më shto diturinë.” (20:114). Atyre që u shtohet dituria, kuptohet nëse përpiqen për të, u është shtuar mirësia e madhe, këta e kanë më lehtë për ta pranuar Fenë Islame. Përse? Sepse janë më të kuptueshëm dhe kuptueshmëria e tyre ua gjen rrugën për t’i udhëzuar drejt Zotit. All-llahu i Madhërueshëm urdhëron e thotë:

“Atyre që u është dhënë dituria, e dinë se kjo që të është shpallur ty është nga Zoti, është e vërtetë dhe se udhëzon për në rrugën e Fuqplotit, të Lavdishmit.” (Kur’ani, 34:6)

E Vërteta Islame që iu shpall Muhammedit (a.s.) në formën e plotësuar, përfundimtare dhe të përsosur, udhëzon çdo ditë për në Rrugën e Drejtë të Zotit Fuqplotë e të Lavdishëm, edhe prijës fetarë të krishterë, çifutë dhe zonja të moshuara. Kur dëshiron Zoti, çdo gjë bëhet!

Quhej Philip John Halford. Në moshën 63 vjeçare e pranoi Fenë Islame dhe tani ka emër të ri, Abdul Ehad. Ky burrë anglez kishte kryer Fakultetin Teologjik dhe kishte shërbyer si prift protestant më se dyzet vjet!

Kur e pyetën se për ç'arsye e ndërroi fenë, z. Abdul Ehad tha: “E kuptova se Islami është Fe e Vërtetë dhe u bëra musliman. Në vitin 1988 për herë të parë u njoha me Fenë Islame. Bëra analiza të thella për veçoritë e Krishterimit dhe të Islamit. Interesimi im u shtua kur i dëgjoja ligjëratat me përmbajtje islame, të cilat i zhvillonin vëllezërit muslimanë.

Përmes tyre u lidha me Qendrën Islame në qytetin e Birmingenit të Anglisë. Fillova ta studioj Kur'anin me të vetmin qëllim: që të njihem për së afërmi, nga vetë burimi, me Fenë Islame... dhe aty e gjeta Qetësinë Shpirtërore...!”

Më në fund, ish-prifti protestant z. Philip John Halford, kurse tash me emrin e ri musliman, Abdul Ehad, tha: “Edhe pse isha i edukuar që nga fëmijëria në frymën e krishterë, kurrë nuk munda ta pranoj idenë se Krishti është bir i Zotit. Mendoj se shumica e besimtarëve të krishterë nuk janë asnjëherë të sigurtë në besimin e tyre...”

Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe me shembjen e komunizmit, në ish-republikat sovjetike numri i besimtarëve po shtohet, sidomos numri i besimtarëve të Fesë Islame. Po, kjo tani është dukuri normale, pasi liria e besimit është e garantuar me ligj për të gjithë. Por a mund të jetë normale që Fenë Isla-me ta pranojë një rabin çifut, prijës fetar, i cili kishte shërbyer në një sinagogë tridhjetë vjet me radhë?

Dihet urrejtja e çifutëve ndaj të gjitha besimeve, e sidomos ndaj Besimit Islam, sepse ata e konsiderojnë veten si “Popull i zgjedhur”. Atëherë, pranimi i Fesë Islame nga një hebre nuk është tjetër veçse një bekim, një udhëzim nga All-llahu, i Cili është Burim i Dashurisë, Mëshirës e Dritës. Ai nxjerr nga errësira në dritë kë të dëshirojë...!

Muslimani i ri, ish-rabini çifut, pasi e pranoi Fenë Islame, e ndërroi emrin dhe tani quhet Ibrahim Ismail. Meqë kishte zë të bukur, të lartë e tingëllues, z. Ibrahim Ismaili e caktuan muedh-dhin (myezin) në Xhaminë e Madhe, në qytetin Margelanu të Uzbekistanit. Këtë detyrë, sa të shenjtë aq edhe fisnike, ai po e kryen me nder e me përkushtim.

Një zonjë gjermane, pasi e pranoi Fenë Islame, tha: “Një ditë, djali im me sy të përлотur më tha: “Nuk dua të jem më i krishterë. Unë dëshiroj të bëhem musliman, të kaloj në Fenë Islame. Edhe ti, nëna ime e dashur, duhet t’i bashkohesh kësaj feje, bashkë me mua!”

Kaluan vite dhe erdha në përfundim se Feja Islame është Fe e Vërtetë! Për këtë fe së pari dëgjova nga djali im, kur më erdhi i përлотur e më tha: “Nuk dua më të jem i krishterë...!”

Pasi e studiova Fenë Islame thellësisht, menjëherë e refuzova të rrefyerit, pagëzimin, shenjtërinë e Papës...! Besimi për Trininë (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë) ishte i papranueshëm për mua, jobindës, qysh kur isha e re, që në moshën njëzetvje-çare.

Me ndihmën dhe në praninë e imamit të Xhamisë së Berlinit thashë Fjalën e Dëshmisë:

“S’ka zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi (a.s.) është i Dërguari i Tij”.

Kështu edhe zyrtarisht u bëra muslimane, dhe tani quhem Amina Mosler. Jam tejet e gëzuar, fatlume dhe kam qetësinë e duhur. Kështu si jam e falënderoj All-llahun që më udhëzoi. Sot unë jam një gjyshe e lumtur, sepse kam një nip i cili është musliman i lindur...!”

## **DR. ROLF BARON EHRENFELS, SHKENCËTAR, ANTROPOLOG (AUSTRI)**

Dr. Rolf Baron Ehrenfels rrjedh prej një familjeje shumë të njohur austriake. Është djali i vetëm i shkencëtarit të madh Baron Hristian Ehrenfelsit, themeluesit të Psikologjisë Moderne Strukturore në Austri, (Modern Structural (Gestalt) Psychology). Që në fëmijëri, Rolf Ehrenfelsi kishte simpati të përgjithshme e dashuri të veçantë për Orientin, sidomos për botën islame! Motra e tij, poetja e njohur Imma von Bodmershof, e përshkruan këtë simpati e dashuri të vëllait për Orientin dhe Islamin në librin “Islamic Literature”, botuar në gjuhën angleze më 1953, në Lahore, Pakistan.

Në moshë të re Rolf Ehrenfelsi i bëri vizitë Ballkanit dhe, kudo që shkonte, hynte edhe nëpër xhami e falej me besimtarët muslimanë, edhe pse ishte i krishterë! “Ngado që shkoja” - siç shkruan ai më vonë në kujtimet e veta - *“muslimanët e Ballka-nit (ndër ta i përmend edhe shqiptarët) më bënin pritje të përçemërt. Kjo më la përshtypje të thellë, ma shtoi edhe më tepër dashurinë për Fenë Islame, për muslimanët...”* Nuk shkoi gjatë dhe ai u bë musliman, e përqafoi Fenë Islame dhe e ndërroi emrin, atë emër që e kishte aq të njohur...! E zgjodhi emrin Umer.

Umer Ehrenfelsi, tani me emrin e ri musliman, shkoi në Nënkontinentin Indo-Pakistanez me qëllim të veçantë: të hulumtojë çështjet, problemet kulturore-historike që kanë lidhshmëri me statusin dhe pozitën e femrës në shoqëri. Pas këtyre studimeve e hulumtimeve, kthehet në Austri dhe po aty kryen specializimin në antropologji. Universiteti i Oxfordit i boton librin e parë me titull “Studime Antropologjike në Indi”.

Dr. Umer Ehrenfelsi pas disa vitesh kthehet përsëri në Indi dhe vendoset në qytetin Hajdarabad, ku vazhdoi kontributin e tij në fushën e antropologjisë, i ndihmuar në hulumtime të ndryshme nga Fondacioni “Wener-Gern Foundation” i Nju-Jorkut.

Vite me radhë dr. Umeri ka qenë drejtor i Departamentit Antropologjik në Universitetin e Madrasit, ku veprimtaria e tij origjinale në fushën sociale-kulturore-antropologjike është shpërblyer me medalje të artë nga “Royal Asiatic Society of Bengali” (Shoqata Mbretërore Aziatike e Bengalit).

Ka publikuar dy vëllime të njohura në rrethet shkencore “General Anthropology”, Delhi, 1941, e po ashtu ka botuar edhe shumë vepra të tjera shkencore, fetare-islame etj.

Por, për ç’arsye vallë, ky emër kaq i njohur dhe me karrierë të shkëlqyeshme u bë musliman dhe pranoi Fenë Islame?

Dr. Umer Ehrenfelsi deklaroi:

“Mësimet Islame janë vazhdimësi e zbulimeve hyjnore. Të gjitha religjionet e mëdha rrjedhin prej një burimi. Pejgamb-erët e përgatitën njerëzimin për paqe dhe dëshmuar se mësi-met dhe porositë e tyre nuk ishin veçse Frymëzime hyjnore. Pranimi i tyre do të thotë se je kërkues i Dashurisë, gjurmues i së Vërtetës Hyjnore.”

Termi “Islam”, në thelb ka kuptimin paqe, bindje, nën-shtrim ndaj vullnetit të Zotit. Historikisht, Feja Islame është feja e fundit prej feve të mëdha botërore në planetin tonë. Pejgamberi Muhammed (a.s.) është Lajmëtari i Fundit prej të Dërguarve e të zgjedhurve të All-llahut.

Pranimi i Fesë Islame nga pjesëtarët e feve të tjera nuk do të thotë mohim i fesë së tyre, por vazhdimësi e së Vërtetës së Përsosur. Ndryshimet ndërmjet religjioneve janë pasojë e ndërhyrjeve njerëzore. Njësimi është hyjnor. Themelin e këtj Njësi-mi e thekson qartë Kur’ani i Shenjtë në porositë e tij. Dëshmimi i kësaj do të thotë pranim i një fakti të vërtetë shpirtëror, që është i përbashkët për mbarë njerëzimin.

Në Fenë Islame theksohet më së miri Vëllazërimi Shpirtëror, ku nuk ka vend për racizëm, sektarizëm, qoftë nga ana kombëtare, gjuhësore, historike etj.

Koncepti i Dashurisë Hyjnore, që frymëzon dashurinë amnore, shprehet në Emrat e All-llahut (Esma ul-Husna), si: Er-Rrahman, Er-Rrahim, të cilët rrjedhin nga gjuha arabe prej rrënjës RHM. Një kuptim të përfaqësues simbolik e gjejmë edhe te Gëteja: (Das Ewing - Weibliche Zihet uns Hinan,) që ka kuptimin themelor: Mitër.

Këtë kuptim kanë fjalët e paharrueshme të Pejgamberit (a.s.), kur u tha shokëve të vet:

“Xhenneti qëndron nën këmbët e nënës.”

## **MUHAMMED SULEJMAN TAKEUCHI, ETNOLOG (TOKIO, JAPONI)**

Japonia, me sipërfaqe prej 372.154 km., ose 143.689 milje katrore, me popullsi prej rreth 150 milionë banorë, është shteti më i zhvilluar në Azi dhe një nga shtetet më të zhvilluara e më të përparuara në rruzullin tokësor.

Vështruar nga jashtë, zhvillimi dhe përparimi teknologjik i Japonisë vlerësohet lart, çmohet dhe admirohet kudo në botë. Japonezët, që janë një popull i vyeshëm, i talentuar, këtë zhvillim e arritën me dije, punë të vazhdueshme, organizim të lartë dhe disiplinë të fortë. Por, ky zhvillim e përparim i madh, i hovshëm, është i njëanshëm, vetëm në aspektin material dhe në përpjekjet e përditshme për ekzistencë, për ta ngritur standa-rdin sa më lart. Megjithëkëtë, përpjekjet për t'u pasuruar, japo-nezët po ndihen gjithnjë e më të varfër në aspektin shpirtëror. Kriza shpirtërore po përhapet me shpejtësi, duke përfshirë gati të gjitha shtresat e popullsisë...!

Megjithë mirëqenien materiale që kanë arritur, për të cilën ua kanë lakmi shumë popuj, japonezët po ndihen përditë e më të dëshpëruar, më të shqetësuar dhe shpirtërisht më të zbrazët e të trishtuar. Këtë zbrazëti, që po i mundon shumë, ata po përpiqen ta plotësojnë me pije të ndryshme alkoolike, me narkotikë të lloj-llojshëm dhe me marrëzira të ndryshme.

Frytet e kësaj jete të shfrenuar më tepër po i “gëzon” rinia, dhe si pasojë e kësaj janë krimet e përditshme, vrasjet, dhunimet, e sidomos vetëvrasjet tepër tragjike, me pasoja afat-gjata për familjet, rrethin dhe mbarë shoqërinë...!

Por, me gjithë këto probleme e shqetësime të shoqërisë japoneze, që po e trondisin mbarë shtetin, fatmirësisht ka individë dhe grupe të veçanta të profesioneve të ndryshme që kanë gjetur kuptimin e jetës, sigurinë dhe shpëtimin! Por, ku? Në Fenë Islame!

Njëri nga këta është profesori i etnologjisë nga Tokioja, Muhammed Sulejman Takeuchi, i cili është anëtar i Shoqatës së Etnologëve Japonezë, me qendër në kryeqytet. Muhammed Sulejman Takeuchi, ky etnolog i shquar, pasi e pranoi Fenë Isla-me, për mjetet e informimit, që ishin aq kureshtarë, dha këtë deklaratë:

“Së pari e falënderoj All-llahun, se me ndihmën dhe dashamirësinë e Tij unë e përqafova Islamin. Tani quhem Muhammed Sulejman Takeuchi. Feja Islame më joshi kryesisht për këto arsye:

1. Unë gjeta një vëllazërim të vërtetë ndërmjet besim-tarëve.
2. Feja Islame ofron zgjidhje praktike për të gjitha problemet e jetës.
3. Balancimi i materialeve dhe shpirtërores pothuajse më detyroi që ta pranoj këtë fe të përsosur.

Vëllazëria islame nuk njeh dhe nuk pranon pengesa, kufij kombëtar, gjuhësor, racor, etnologjikë etj. Aq më tepër, Feja Islame nuk i takon vetëm një grupi të veçantë, por është një fe për mbarë njerëzimin, qoftë nga Pakistani, India, Afganistani, Kina, Japonia apo nga vendet arabe... Shkurt, është një besim ndërkombëtar, ku të gjithë do të gjejnë shpëtim!

Feja Islame është e pastër dhe natyrore. Gjatë 14-të shekujve, që kur filloi t'i shpallet Pejgamberit Muhammed (a.s.), ajo plotëson çdo nevojë në çdo vend, në çdo kohë, për çdo bashkësi, për çdo

gjeneratë... Historia është dëshmitare për kontributin madhështor që ka dhënë Feja Islame në zhvillimin dhe përparimin e njerëzimit në shumë sfera të jetës...

Ndryshe nga besimet e tjera, në Fenë Islame rruga për në shpëtim kalon nëpërmjet jetës shoqërore, duke nxitur bashkëpunimin dhe mirëkuptimin për të mirën e përbashkët.

Unë kam njohuri edhe rreth religjioneve të tjera, si rreth Budizmit dhe Krishtërit. Këto dy religjione na mësojnë e na porosisin, ndër të tjera, që jetën shoqërore, jetën e kësaj bote të përkohshme, mos ta përfillim fare...! Disa sekte budiste i kanë ndërtuar tempujt e tyre fetar nëpër vende malore, ku mund të shkohet me shumë vështirësi. Po ashtu, shumë të krishterë i kanë themeluar manastiret e tyre në vende të vetmuara, të izoluara nga populli...

Kurse në Fenë Islame nuk kanë ndodhur gjëra të këtilla, meqë xhamia është kudo: në mes të fshatit, në zemër të çdo mëhalle, në mesin e tregut të çdo qyteti. Të gjithë besimtarët muslimanë e ndiejnë gëzimin e kënaqësinë e namazit pesë herë në ditë, që është një nga shtyllat kryesore të fesë...

Sot jeta në Japoni, edhe pse është vendi më i zhvilluar, më i industrializuar dhe më i përparuar, vazhdimisht keqësohet dhe varfërohet në aspektin shpirtëror... Në Japoni po ecim gjurmëve të Evropës materialiste dhe, si rezultat i kësaj jeta jonë është gjithnjë e më e pakuptimtë, më e pakënaqshme, jemi më të shqetësuar e më të dëshpëruar...!

Lavdi All-llahut të Madhërueshëm, unë e gjeta shpëtimin në Fenë Islame. Jam një besimtar i ri që e pranova këtë fe para dy vjetëve, por që e njoh nga ana teorike dhe praktike. Dhe me të vërtetë

jam i kënaqur! Dëshmoj se s'ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi (a.s.) është i Dërguari i Tij!”

## **DR. R. L. MELLEME, ANTROPOLOG (HOLANDË)**

Dr. R.L. Melleme është një intelektual i shquar evropian nga Holanda, me profesion linguist dhe antropolog, autor i disa veprave. Prej tyre, më të njohura janë: *“Wayang Puppets”*, *“Grundwet von Pakistan”*, *“En Interpretatie van de Islam”*, *“A Short Guide on Islam in Java”* etj. Dr. Melleme është drejtor i Muzeut Tropikal në Amsterdam, Holandë.

Si e zbuloi të Vërtetën ky shkencëtar i shquar holandez? Ja dëshmia e tij:

“I fillova studimet e gjuhëve të Lindjes në Universitetin e Leidenit, te profesori Snouck Hurgonje, një arabolog i mirënjohur, e njëkohësisht studiova edhe gjuhën sanskrite, malaje dhe javaneze. Më vonë qëndrova një kohë bukur të gjatë nëpër të gjitha vendet ku fliten këto gjuhë aziatike. Qëndrova edhe në Kajro të Egjiptit, ku dhe qëndrova në Universitetin “El-Az’har.” Pas këtyre vizitave studimore, ku përjetova vështirësi e peripeci të ndryshme, u ktheva në Holandë, dhe u punësova në “The Royal Tropical Institute” të Amsterdemit. Këtu, në këtë institut, gjeta rastin të vazhdoja studimet islame. Po këtu, ndërkohë, përpilova një libër me titull “Islami në ishullin Java, Indonezi”.

Në dimrin e vitit 1954/1955 fillova të punoj në Lahore, në fakt të studioj shtetin e ri të posaformuar, Republikën Islame të Pakistanit. Unë deri më atë ditë e njihja Islamit vetëm nga librat e shkrimtarëve evropianë. Me të ardhur këtu, menjëherë hasa në vështirësi të ndryshme, kështu që u detyrova të kërkoj ndihmën e miqve të mi pakistanezë, të cilët jo vetëm që më ndihmuan, por edhe më lejuan të marr pjesë në lutjet e tyre në xhami... Këtu në xhami, ditën e premte, në namazin e xhumasë, fillova t'i zbuloj vlerat e larta dhe të vërteta të Fesë Islame. Nga ky moment i paharrueshëm, jo vetëm që e ndjeva veten musliman, por pa hezitim dëshmovava se jam musliman!

Pas një kohe m'u dha rasti të predikoj nga minberi i xhamisë në Lahore, që bëri jehonë dhe la përshtypje të madhe te dëgjuesit, që ishin me qindra, të cilët m'i shtrëngonin duart e më përqafonin vëllazërisht.

Predikimi që mbajta në këtë xhami u botua në revistën "Pakistan Quarterly", vëll. V./1955. Pas këtij botimi m'u shtuan edhe miq të tjerë, në mesin e të cilëve ndihesha si në mes të vëllezërve. Populli i Pakistanit, më la përshtypje të thellë, më bëri t'i njoh edhe më mirë vlerat e Fesë Islame, shumë më tepër seç i njihja prej librave të shkruara nga autorët e ndryshëm evropianë.

Më pyesin shpesh: "Cila është madhështia dhe bukuria e Islamit, e në veçanti ç'është ajo që më joshi ta përqafoj këtë fe?" "Është njohuria e saktë për Zotin, i Cili është Një. Prej Madhërisë së Tij të pakufishme varemi të gjithë. Ai nuk ka lindur e as që është i lindur. Atij askush nuk i ngjason. Ai është i Gjithëdijshëm, i Plotfuqishëm, bamirësia e mëshira e Tij nuk njohin kufij. Këto cilësi të Tij, e shumë të tjera, janë të qarta dhe të pranueshme për çdo njeri me arsye të shëndoshë.

Besimtari në Fenë Islame nuk ka nevojë për ndërmjetësim apo ndërmjetës dhe kjo fe nuk njihet kler fetar, si fetë e tjera. Kontaktet me Zotin janë të drejtpërdrejta, pa ndërhyrjen apo ndërmjetësimin e askujt. Njeriu në këtë botë duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme dhe të përgatitet për botën tjetër. Për veprat e mira do të shpërblehet, ndërsa për veprat e liga do të ndëshkohet. Askush s'mund t'i kompensojë ose t'i falë asgjë askujt! Askush nuk ngarkohet përtej mundësive që ka...

Toleranca, aq e nevojshme për të gjithë, në Fenë Islame është përcaktuar qartë:

“Në fe nuk ka dhunë, është sqaruar e vërteta nga rrena...” (Kur’ani, 2:256)

Besimtari është i porositur, i obliguar që të kërkojë e të hulumtojë të vërtetën, të kërkojë diturinë qoftë edhe në Kinë.

Feja Islame na vëllazëron të gjithëve sepse nuk njihet kufij gjuhësor, kombëtar, racor as pozitë shoqërore, ekonomike e politike. Të gjithë në këtë botë jemi të njëjtë para të Madhit Zot! Vetëm Feja Islame e realizoi këtë doktrinë në praktikë. Muslimanët, kudo në botë, e konsiderojnë njëri-tjetrin si vëllazër! Ky vëllazërim, kjo barazi, manifestohet më së miri në Haxhë, ku të gjithë haxhilerët janë të veshur me të njëjtin petk (ihramin).

Ndalimi i pijeve alkoolike dhe konsumimi i narkotikëve është një veçanti në Fenë Islame, e cila në të ardhmen do t'ia shtojë nderin dhe do ta lartësojë edhe më tepër këtë fe. Kjo dëshmon qartë se Islami është para kohës...”

## MUHAMMED A. RUSSEL WEBB, DIPLOMAT (SHBA)

Alexandër Russel Webb, amerikan, lindi në qytetin Hadson të shtetit Nju-Jork, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pas diplomimit merrej me krijimtari letrare-artistike, duke shkruar ese dhe tregime të ndryshme. Më vonë filloi të merrej edhe me gazetari dhe ishte mjaft i suksesshëm. Arriti të udhëheqë dy gazeta të njohura “*Saint Joseph Gazette*” dhe “*Missouri Republican*”. Dikur, pasi u bë mjaft i njohur, e la gazetarinë dhe kaloi në diplomaci. U emërua konsull dhe e caktuan të shërbejë në Manilë të Filipineve. Gjatë kësaj kohe, sa ishte duke kryer shër-bimin diplomatik, filloi të interesohet për Fenë Islame. Sa më mirë që e njihnte Islamin, aq më tepër i shtohet dashuria për të! Dhe një ditë e pranoi Islamin me zemër e me shpirt!

Pasi e pranoi Fenë Islame, amerikanin Alexandër Russel Webb e ndërroi edhe emrin dhe tani gëzon emrin e lavdëruar Muhammed Webb. Ky zotëri i ndershëm, tani besimtar, ia mësyu Botës islame prej skajit në skaj! Vizitoi shumë vende e popuj dhe, kudo që shkonte, ato vizita merrnin edhe karakter studimor.

Pjesën që i mbeti prej jetës tokësore, dhe atë që i kishte mbetur prej kursimeve jetësore, vendosi që ta shpenzojë për çështjen islame, me të vetmin qëllim: Që me përkushtim të thellë ta përhapë kudo Fenë Islame!

Për shqiptarët e shkretë që ndodhen në udhëkryq, të hutuar, të mashtuar dhe shumë të dëshpëruar, më poshtë po paraqesim dëshminë e të konvertuarit të fundit të këtij libri, po u paraqesim dëshminë e diplomatit amerikan, se si erdhi deri tek e Vërteta Islame dhe për çfarë arsye u bë musliman!

“Përse unë, një amerikan i lindur në një vend kryesisht të krishterë, ku jam edukuar e ku jam rritur në një rreth ku dominon Kisha Protestante Presbiteriane, e pranova Fenë Islame si të vetmen udhërrëfyese të jetës?

Mund t’ju them menjëherë me krenari, sinqeritet e vërtetësi, se këtë fe e pranova sepse në të zbulova, pas studimeve serioze e të thella, se Feja Islame është feja më e përsosur dhe i vetmi sistem jete që u përshtatet nevojave shpirtërore.

Që në moshën njëzetvjeçare kur praktikisht, si thonë, u bëra i zoti i vetvetes, në atë kohë isha aq i mërzitur, i penguar, i kufizuar dhe i zhgënjyer nga Kisha Protestante Presbiteriane, sa që u detyrova ta braktisja e të largohem njëherë e përgjithmonë, për të mos u kthyer kurrë më tek ajo...!

Ndonëse isha një djalë i sjellshëm, tolerant, i kthyeshëm, unë dëshiroja shpjegime për pyetjet që i shtroja por, mjerisht, asnjëri, qoftë nga kleri ose laikët, nuk ishin në gjendje të më shpjegonin ose të më jepnin përgjigje të duhura e të kënaqshme! Nuk ishin në gjendje të ma shpjegonin në mënyrë racionale këtë fe (Krishterimin), por, në vend të ndonjë përgjigjeje, më thonin: *“Këto gjëra janë të sbenjta, janë misterio-ze” ose, kinse, “pakuptueshmëria ime s’mund t’i përfshijë...!”*

Para rreth një dekade filluan të zgjohen tek unë dëshira dhe interesimi për studime orientale, në veçanti për religionet e Lindjes (Orientit). Shkrimtarët e mëdhenj dhe dijetarët e njohur si Milli, Locku, Kanti, Hegeli, Fichte, Huxley dhe shumë të tjerë, kush më pak e kush më shumë, rreth çështjeve të ndryshme e më delikate ligjëronin me shumë urtësi, por asnjëri prej tyre nuk qe në gjendje të shpjegojë se: Ç’është thelbi i së Vërtetës?

Thelbi i së Vërtetës është bindja ndaj Vullnetit të All-llahut dhe baza e saj është Namazi. Namazi me përkushtim sjell vëllazërimin e përgjithshëm, dashurinë universale dhe sjell mirësi të shumta: pastërtinë e mendjes, të zemrës e të shpirtit. Pra, kuptohet, sjell pastrim të përgjithshëm dhe të përsosur.

Feja Islame, pa dyshim, është më e thjeshta, më e lehta dhe më e larta, prej të gjitha feve qiellore që ka njohur njeriu...”.

## **TREGIMI I PRANIMIT TË ISLAMIT NGA NJË VAJZË ÇIFUTE**

Si e pranova Islamin?

O vëllezër, këtë fe të madhërishtme, Islamin, në qoftë se do ta prezantonim mirë dhe pastër, atëherë njerëzit do ta praninin shume lehtë për shkak të natyrës së pastër të tyre.

Kjo ngjarje është nxjerrë nga Interneti, ku një grua thotë se e ka parë një vajzë në xhami, në një qytet të vogël të Amerikës, e cila lexonte Kur'anin me komentin në gjuhën angleze. I ka dhënë selam, e ia ka kthyer me buzëqeshje. U ul pranë saj, filluan të bisedojnë e pas një kohe të shkurtër u bënë dy shoqe të mira. Një natë, derisa ishin duke shëtitur, ajo i tregoi shoqes së saj se si e përqafoi fenë Islame. Pra ta dëgjojmë këtë ngjarje:

Tregon kjo vajzë: “Kam jetuar në një familje amerikane çifute të përcarë. Pasi babai u shkurorezua nga nëna, dhe u martua me një grua tjetër, filluan problemet. Pas kësaj ngjarjeje

vendosa të largohem nga shtëpia, e atëherë isha 17 vjeçare, dhe u vendosa në republikën tjetër, ku takova të rinj dhe të reja nga arabët, të ndershëm e bujarë, dhe në fytyrat e tyre vazhdi-misht vërehej buzëqeshje, mirëpo unë shoqërimin me arabët nuk e kam dashur për shkak se i urreja.

Në anën tjetër, nuk isha e kënaqur me jetën time e gjithashtu nuk ndieja qetësi dhe prehje, përkundrazi ndieja ngushtim dhe humbje, dhe për këtë arsye vendosa që t'i kthehem fesë time ashtu që të gjeja qetësi shpirtërore dhe vullnet për jetë, por çifutët me fenë e tyre nuk më bindën, sepse është fe që nuk e respekton gruan, nuk e respekton njeriun, fe që e urreva, sepse gjeta në të prapambetje. Në qoftë se të intereson diçka në të, nuk gjen përgjegje. Pas kësaj pranova Krishterimin, mirëpo krishtërimi kishte edhe më shumë kundërthënie në disa gjëra që nuk i pranon mendja, e madje edhe kërkojnë prej nesh t'i nënshtrohemi dhe t'i pranojmë. Kam pyetur shumë si ka mundësi ta mbysë Zoti birin e Vet? Si lind Ai? Si mund të ketë feja jonë tre zota, e nuk e shohim asnjërin prej tyre? U demoralizova, e lashë çdo gjë, por e dija se ka krijues, dhe çdo natë mendoja deri në agim. Një natë, para agimit desha të bëja vetëvrasje prej gjendjes së keqe që mbretëronte tek unë. Çdo gjë ishte e pakuptimtë për mua! Shiu binte pandërprerë, sikur të ishte burg që më rrethon, gjithësia rreth meje më mbyste. Pra, derisa qëndroja pranë dritares në një shtëpi ta braktisur, gjeta veten duke e lutur Zotin: “O Zot e di se je këtu, e di se më do mua, unë jam e braktisur, unë jam krijesa jote e dobët, më udhëzo në rrugën Tënde, o më udhëzo o më mbytl!” Qava me të madhe, derisa më zuri gjumi. Në mëngjes u ngrita me zemër të hapur, një ndjenjë e huaj për mua. Dola si zakonisht, të kërkoja furnizim. Ndoshta do të gjeja dikë të më paguante mëngjesin, apo të pastroja enë e të merrija pak të holla. U takova me një djalosh arab, me të cilin bisedova gjatë, e ky kërkoi nga unë që pas mëngjesit të shkoj tek ai, në shtëpinë e tij, dhe më ofroi të jetoja me të. Shkova tek ai dhe derisa ishim duke ngrënë drekë, duke pirë dhe

duke qeshur, hyri një djalosh me mjekër i cili quhej Sead, siç e mësova nga shoku im që i habitur e thirri me këtë emër. Kurse unë mbeta e frikësuar përballë një terroristi, fundamentalisti. Mirëpo ky nuk bëri asgjë të jashtëzakonshme, por kërkoi nga unë me shumë respekt dhe edukatë të shkoja në shtëpinë time. I thashë atij se unë nuk kam shtëpi. Ai më shikoi me dhembje, e këtë e vëreja në fytyrën e tij, e pastaj më tha: “Mirë, rri këtu këtë natë (ishte shumë ftohtë), merri këto të holla dhe të nesërmen shko. Këto të holla do të të ndihmojnë derisa të gjesh punë.” Posa deshi të dalë, e falënderova dhe i thashë: “Unë do të dal e ti rri këtu, por më trego, të lutem përse u solle ashtu me shokun tënd, ndërsa me mua ke sjellje tjetër. “U ul dhe filloi të flasë, gjersa shikimi i tij ishte vazhdimisht i ulur - shkak i kësaj sjelljeje është Islami, që ndalon veprat e këqija: ndalon vetminë me gratë e huaja, pirjen e alkoolit, nxit në bamirësi, në sjellje (edukatë) të mirë.

U shtanga nga habia. A janë këta për të cilët thuhet se janë terroristë? Mendoja se mbajnë armë dhe vrasin çdonjërin që u del para! Kështu më kishin mësuar mediat amerikane. I thashë: “Dua të më mësosh më shumë për Islamin!” Më tha: “Do të shkojmë së bashku te një familje fetare muslimane, do të qënd-rosh aty dhe besoj se ata do të mësojnë për çdo të mirë.” Shkuam tek ajo familje në ora dhjetë të mbrëmjes, e ata na pritën shumë mirë. Kështu fillova të shtroja pyetje për gjërat të cilat më mundonin qysh moti, ndërsa Dr. Sulejmani, i zoti i shtëpisë, përgjigjej, derisa u binda plotësisht. U binda se e gjeta atë që e kërkoja si përgjigje të pyetjeve që kisha.

Fe e qartë, e pastër, që përputhet me natyrën e njeriut. Nuk gjeta asnjë vështirësi të besoja çdo gjë që dëgjova, sepse të gjitha ishin të vërteta. Kur e pranova Islamin ndjeva një ringja-llje të papërshkrueshme dhe po atë ditë e vendosa mbulesën (hixhabin).

Në ora një të mesnatës, zonja e shtëpisë më vendosi në dhomën më të bukur dhe më tha: “Kjo është dhoma jote, rri në të sa të duash.” Pas kësaj më vërejti se isha duke shikuar në dritare e buzëqeshur, e të njëjtën kohë më rridhnin lotët. Më pyeti për gjendjen time. I thashë: “Mbrëmë, saktësisht në këtë kohë, qëndroja pranë dritares dhe lutja Zotin, o të më udhëzojë në rrugën e drejtë, o të më mbysë. Më udhëzoi dhe më nderoi, ndërsa unë tani jam muslimane. Kjo është e vërteta, kjo është e vërteta.” Atëherë zonja e shtëpisë më përqafoi dhe filloi të qajë së bashku me mua.”

## DY FJALË PËRMBYLLËSE

Sa’adiu, filozof e vjershëtar i kalibrit botëror, i cili ka qenë 14-të herë në haxh, njëherë ka thënë:

“Dy gjëra i turbullojnë mendjet në botë: Kur lypset të flasësh, s’flet, e kur s’lypet, flet kot.”

Lexues të nderuar!

Nëse këto dëshmi jete të të konvertuarve nga mbarë bota, që nga Amerika në Japoni, që nga Afrika në Australi, ju kanë shtyrë të mendoni, atëherë, mendoni! Por, siç ka thënë Imam Aliu (r.a.): *“Mendoni për atë që është thënë, e jo për atë se kush e ka thënë.”*

Besimi në All-llahun, Krijuesin e Gjithësisë dhe njohja e së Vërtetës kur’anore e lirojnë mendjen e besimtarit nga prangat e robërisë, nga iluzionet, nga kotësitë, nga mashtrimet dhe e ndihmojnë që të zhvillojë mënyra të shëndosha të mendimit e të veprimit.

Udhëheqja hyjnore na ndihmon t'u japim përparësi gjërave që kanë vlerë e që janë të dobishme në të dy jetët.

Shqiptarët, në veçanti ata në trojet e veta etnike, edhe pse të lodhur, të dëshpëruar, të zhgënjyer, të pikëlluar e të çorientuar, nuk duhet të humbin shpresën! Mëshira e All-llahut e tejkalon zemërimin e tyre!

Feja Islame është dritë dhe kërkon nga besimtarët që të mos jetojnë në errësirën e paditurisë, por të ndriçohen me dritën e mendjes. Me ndryshimin tonë, do të ndryshojë edhe gjendja jonë...

O Zot! Na udhëzo e na forco në rrugën e drejtë. Na largo nga veprimet për të cilat më vonë do të pendohemi!

Për Ty janë falënderimi e lavdia! Le të jenë paqja dhe shpëtimi mbi Muhammedin (a.s.), mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë besimtarët! Amin!

Mexhid Yveysi, Gjakovë, 1418/1997